

VENDIM
Nr. 209, datë 6.4.2022

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, pika 2, 23, pika 10, 25, pika 1, 27, pika 8, 28, pika 1, 34, pika 2, 35, pika 4, 43, pika 9, 49, pika 14, 52, pika 1, 53, pika 3, 54, pika 6, 56, pika 1, 58, pika 8, 60, pika 3, 64, pika 8, 66, pika 5, 67, pika 7, 71, pika 4, 73, pika 6, 77, pika 3, 78, pika 10, 79, pika 2, 84, pika 4, të ligjit nr. 81, datë 25.6.2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”; të neneve 13, pika 7, e 16, pika 7, të ligjit nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”, si dhe të neneve 105, pika 5, 111, pika 2, 113, pika 6, 120, pika 5, 122, pika 1, 124, pika 2, 125, pika 5, 126, pika 4, 127, pika 4, të ligjit nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore së përgjithshme të burgjeve, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Vendimi nr. 437, datë 20.5.2015, i Këshilli të Ministrave, “Për miratimin e rregullore së përgjithshme të burgjeve”, shfuqizohet.
 3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

RREGULLORE E PËRGJITHSHME E BURGJEVE

KREU I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e sistemit të burgjeve, disiplinën e brendshme, trajtimin me dinjitet dhe respektimin e të drejtave themelore të të burgosurve, kushtet e jetesës në institucion, mjediset, normat e sjelljes së të burgosurve, me qëllim rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre, si dhe çdo element që lidhet me ekzekutimin e vendimeve penale, sipas parashikimeve ligjore.

Neni 2
Parime të përgjithshme

Sistemi i burgjeve, në ushtrimin e veprimtarisë, udhëhiqet nga parimet dhe respektimi i të drejtave si më poshtë vijon:

1. I burgosuri trajtohet me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat e tij njerëzore.
2. I burgosuri gëzon të gjitha të drejtat që nuk i janë kufizuar apo hequr në mënyrë të ligjshme nga vendimet e dënimit apo masat e sigurisë me burgim.

3. Kushtet në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, që cenojnë të drejtat e njeriut, nuk justifikohen nga mungesa e burimeve.

4. Jetesa në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale përafrohet sa më shumë të jetë e mundur me jetën në komunitet.

5. Koha e burgimit menaxhohet në mënyrë të tillë që të lehtësojë riintegrimin në shoqëri të personave, të cilëve u është hequr apo kufizuar liria.

6. I burgosuri, gjatë pranimit në institucion dhe kur është e nevojshme dhe gjatë qëndrimit, njoftohet me shkrim dhe me gojë, në një gjuhë që ai e kupton ose njeh, për rregullat dhe disiplinën në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe për të drejtat dhe detyrimet gjatë kohës së qëndrimit në institucion.

7. Të drejtat e të burgosurit mund të kufizohen në minimumin e nevojshëm dhe vetëm në përmbushje të një qëllimi të ligjshëm, në rastet dhe sipas kriterëve të parashikuara në ligj dhe në këtë rregullore.

8. Masat e posaçme të sigurisë së lartë, për kufizimin e të drejtave të të dënuarit, merren vetëm në raste përjashtimore, në rastet dhe sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve.

9. Masat e veçanta, që janë të nevojshme të zbatohen për respektimin e lirive dhe të drejtave të grupeve të veçanta të të burgosurve, nuk konsiderohen diskriminim.

10. Masat disiplinore janë mjeti i fundit ndaj të burgosurve që shkelin rregullat e sjelljes në institucion dhe asnjë të burgosuri nuk mund t'i caktohen dy masa për të njëjtën shkelje.

11. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale menaxhohen brenda një kuadri etik, që njeh të drejtën për të trajtuar të gjithë të burgosurit me humanizëm dhe me respekt për dinjitetin e tyre.

12. Punësimi, trajnimi dhe kushtet e punës së personelit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, duhet të mundësojnë zbatimin e standardeve të larta në kujdesin ndaj të burgosurve.

13. Personeli punon sipas standardeve të larta profesionale dhe personale, të parashikuara në legjislacionin në fuqi, për trajtimin e të burgosurve dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

14. Inkurajimi i bashkëpunimit me shërbime të jashtme shoqërore dhe përfshirja e organizatave jofitimprurëse apo personave juridikë privatë në sistemin e burgjeve.

15. Autoritetet e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale informojnë në mënyrë të vazhdueshme publikun rreth qëllimit të sistemit të burgjeve dhe punës së bërë nga personeli, në mënyrë që të kuptohet roli i këtyre institucioneve nga publiku.

16. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale janë subjekt i inspektimit të rregullt dhe monitorimit të pavarur.

Neni 3 Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje, të gjithë termat e përcaktuar në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve kanë të njëjtin kuptim, ndërsa termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

1. “Risku” është probabiliteti i lartë i kryerjes së mëtejshme të një vepre penale shumë të dhunshme apo vepre penale me natyrë seksuale ndaj personave të tjerë.

2. “Vlerësimi i riskut” është procesi që bën të mundur të kuptohet risku, duke analizuar natyrën, shkallën dhe modelin e shkeljes dhe duke evidentuar karakteristikat e autorit dhe rrethanat, që kanë kontribuar në kryerjen e shkeljes, si dhe që shërben për marrjen e vendimeve nga organet përkatëse në kuadër të uljes së riskut.

3. “Trajtimi” përfshin, por jo vetëm, kujdesin shëndetësor, psikologjik ose social për qëllime terapeutike, i cili shërben për të ulur riskun që paraqet personi dhe mund të përfshijë masa që përmirësojnë dimensionin social të jetës së autorit.

KREU II ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SISTEMIT TË BURGJEVE

Neni 4

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale

1. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale janë degë territoriale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilët janë përgjegjës për pritjen, sistemimin, trajtimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e të burgosurve.

2. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale drejtohen, mbikëqyren dhe përfaqësohen nga drejtori i institucionit.

3. Krijimi, klasifikimi dhe mbyllja e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale me burgim ose seksioneve të veçanta në këto institucione, bëhen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

Neni 5

Drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale

1. Drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale është përgjegjës për garantimin e sigurisë, drejtimin, organizimin, funksionimin dhe kontrollin e ligjshmërisë së veprimtarisë së personelit në institucion, si dhe për respektimin e të drejtave të të burgosurve, trajtimin e paanshëm të tyre, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me rregulloren e brendshme të institucionit.

2. Drejtori i institucionit është përfaqësues ligjor i institucionit në raport me të tretët.

3. Drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale informon në mënyrë të vazhdueshme drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve, lidhur me menaxhimin e veprimtarisë së institucionit.

4. Drejtori i institucionit emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga ministri i Drejtësisë, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

5. Drejtori i institucionit, në rast mungese, zëvendësohet nga zëvendësdrejtori i institucionit ose në mungesë të zëvendësdrejtorit nga funksionari më i lartë i Policisë së Burgjeve në institucion.

Neni 6

Aktivitetet në institucion

1. Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale merr masa për garantimin e sigurisë dhe zbatimin e aktiviteteve në institucion. Rregullat e detajuara të sigurisë dhe zbatimi i aktiviteteve përcaktohen në rregulloren e brendshme të çdo institucioni, si dhe me programe të tjera të miratuara nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve apo drejtori i institucionit.

2. Personeli i institucionit, në përputhje me përshkrimet e punës, bën të mundur zbatimin e detyrimeve, në përputhje me pikën 1, të këtij neni.

3. Drejtori i institucionit mbikëqyr zbatimin e aktiviteteve ditore nga personeli përgjegjës, sipas shërbimeve përkatëse.

Neni 7

Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve

1. Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve krijohet dhe funksionon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

2. Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë vijon:

- a) një përfaqësues i shërbimit të sigurisë;
- b) një përfaqësues i sektorit ligjor;
- c) një përfaqësues i sektorit të çështjeve shoqërore;
- ç) një përfaqësues i shërbimit shëndetësor;
- d) specialisti i sektorit të kujdesit social;
- dh) përfaqësuesi i sektorit ligjor, i cili kryen rolin e kryetarit të Komisionit.

3. Me përjashtim të shkronjës “d”, të pikës 2, të këtij neni, caktimi i anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve bëhet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe ndryshon 1 (një) herë në vit.

Neni 8

Vlerësimi i rrezikshmërisë së të dënuarve

1. Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve harton raportin e vlerësimit të rrezikshmërisë për të dënuarin në rastet kur:

- a) i kërkohet nga gjykata, në çdo rast që shqyrton një kërkesë, për ndryshimin e klasifikimit të sigurisë së të dënuarit;
- b) i kërkohet kalimi i të dënuarit nga një institucion i sigurisë së zakonshme në një institucion të sigurisë së ulët dhe anasjelltas;
- c) i kërkohet kalimi i të dënuarit nga një institucion i sigurisë së ulët në një institucion të hapur dhe anasjelltas;
- ç) në rastet e vendosjes së të burgosurit në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë.

2. Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve, në rastin e ndryshimit të klasifikimit të sigurisë për të dënuarit që vuajnë dënimin në institucionin e sigurisë së lartë dhe për të dënuarit, të cilët gjatë ekzekutimit të dënimit janë karakterizuar nga qëndrime ose sjellje, që e bëjnë të pamundur qëndrimin në institucionet e kategorive të tjera dhe duhet të kalojnë në një institucion të sigurisë së lartë, harton raportin e vlerësimit të rrezikshmërisë, mbështetur në raportin e vlerësimit të riskut të sigurisë, të hartuar nga institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale, ku i dënuari kryen dënimin.

3. Raporti i Komisionit protokollohet dhe një kopje origjinale e tij administrohet në dosjen personale të të burgosurit.

Neni 9

Procedura e hartimit të raportit të vlerësimit të rrezikshmërisë

1. Pas kërkesës së paraqitur pranë Komisionit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve, kryetari i Komisionit njofton institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, ku i dënuari kryen dënimin, për hartimin e raportit të vlerësimit të riskut të sigurisë.

2. Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale, ku i dënuari kryen dënimin, harton raportin e vlerësimit të riskut të sigurisë dhe ia përcjell Komisionit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve.

3. Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale kryen shqyrtimin e të gjithë dokumentacionit të administruar, në lidhje me kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar dhe të paraburgosur, dhe plotëson raportin e vlerësimit të riskut të sigurisë me të dhëna objektive, konkrete dhe specifike të sjelljes së të dënuarit.

4. Pas marrjes së raportit të vlerësimit të riskut të sigurisë, të hartuar nga institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale, ku i dënuari kryen dënimin, kryetari i Komisionit u kërkon anëtarëve shqyrtimin e raportit dhe i njofton ata për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes.

5. Komisioni harton raportin e vlerësimit të rrezikshmërisë së të dënuarit dhe ia përcjell gjykatës, brenda afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative ose afatit të përcaktuar nga gjykata. Një kopje e raportit të vlerësimit të rrezikshmërisë së të dënuarit i përcillet drejtorit të institucionit dhe administrohet në përputhje me rregulloren e brendshme të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale.

6. Mbledhjet e Komisionit shoqërohen në çdo rast me procesverbal, i cili mbahet nga një prej anëtarëve të komisionit, sipas caktimit nga kryetari i Komisionit.

KREU III PRANIMI DHE REGJISTRIMI I TË BURGOSURVE

Neni 10

Kushtet e pranimi të të paraburgosurve

1. Pranimi i të paraburgosurve në institucion bëhet çdo ditë, pasi është vendosur nga gjykata masa e sigurimit “arrest në burg”.

2. Në çdo rast, të paraburgosurit mbahen në seksione të veçuara nga seksioni i të dënuarve.

3. Pranimi bëhet mbi bazën e dokumentacionit të inventarizuar, i cili përmban dokumentet si më poshtë vijon:

a) vendimin e gjykatës, për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”;

b) urdhrin e ekzekutimit të prokurorit;

c) procesverbalin e ndalimit ose të arrestimit në flagrancë;

ç) procesverbalin e kontrollit personal;

d) formularin e identifikimit me 2 (dy) foto dhe gjurmët e gishtërinjve;

dh) dokumentin e identifikimit (letërnjoftim, kartë identiteti, pasaportë biometrike ose çdo dokument informacioni lidhur me identitetin);

e) dokumentin e kontrollit mjekësor dhe çdo informacion mbi shëndetin e të paraburgosurit, që ka lidhje me mirëqenien e tij fizike dhe mendore.

4. Në rastin kur mungon një nga dokumentet e parashikuara, në pikën 3, të këtij neni, institucioni nuk e pranon të paraburgosurin. Në rastin e shtetasve të huaj, për të cilët është i pamundur sigurimi i dokumenteve të identifikimit, pranimi do të bëhet mbi bazën e dokumenteve të përcaktuar në shkronjat: “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “e”.

5. Në rastin e të paraburgosurve për të cilët është dhënë masa e sigurimit “arrest në burg” dhe ndodhen në një institucion mjekësor, pranimi bëhet në institucionin mjekësor dhe i paraburgosuri merret menjëherë në ruajtje nga Policia e Burgjeve.

Neni 11

Kushtet e pranimi të të dënuarve

1. Pranimi i të dënuarve në institucion bëhet mbi bazën e vendimit të gjykatës dhe kriterëve të legjislacionit për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, sipas përcaktimit nga gjykata ose prokurori të llojit të institucionit dhe institucionit konkret ku i dënuari do të kryejë dënimin. Institucioni konkret, ku i dënuari do të kryejë dënimin, përcaktohet nga prokurori në konsultim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve nxjerr urdhrin për pranimin e të dënuarit në institucionin, ku do të ekzekutohet dënimi, brenda një afati prej 3 (tre) ditësh nga paraqitja e kërkesës zyrtare të strukturave të Policisë së Shtetit për transferimin e të dënuarit në institucion.

3. I dënuari duhet të jetë i shoqëruar me dosjen e tij personale të inventarizuar, e cila përmban:

- a) vendimin e formës së prerë të gjykatës që ka caktuar dënimin me burgim;
- b) urdhrin e prokurorit për ekzekutimin e vendimit;
- c) procesverbalin e ekzekutimit të urdhrin të ekzekutimit ose procesverbalin e arrestimit;
- ç) procesverbalin e kontrollit personal;
- d) formularin e identifikimit me 2 (dy) foto dhe gjurmët e gishtërinjve;
- dh) kartelën personale të të dënuarit;
- e) kartelën e gjendjes shëndetësore;
- ë) dosjen psikosociale për transferimet, nga një institucion në një institucion tjetër;
- f) planin individual të trajtimit në rastin e të burgosurve të mitur;
- g) urdhrin e drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve për pranimin në institucionin ku do të ekzekutohet vendimi i gjykatës;
- gj) dokumentin e identifikimit (letërnjoftim, kartë identiteti, pasaportë biometrike ose çdo dokument informacioni lidhur me identitetin).

4. Kur mungojnë dokumentet e parashikuara në shkronjat: “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, “g” dhe “gj”, të këtij neni, institucioni nuk e pranon të dënuarin. Në rast se mungojnë dokumentet e kërkuara në shkronjat e tjera të këtij neni, i dënuari mund të pranohet në institucion. Institucioni merr masat për plotësimin e dosjes personale të të dënuarit me dokumentet që mungojnë, brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimit të tij.

Neni 12

Regjistrimi i të burgosurit

1. Me paraqitjen e të burgosurit në institucion, personeli përgjegjës verifikon identitetin, si dhe saktësinë e dokumentacionit.

2. Kur identiteti dhe dokumentacioni është i rregullt, hartohet procesverbali i pranimit të të burgosurit, dokumenteve shoqëruese dhe sendeve të tij personale. Në procesverbal shënohet data dhe ora e pranimit dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të pritjes.

3. Në ato raste kur lindin dyshime për identitetin e të burgosurit ose rezultojnë mospërputhje në dokumentacion, njoftohet menjëherë oficeri i policisë gjyqësore dhe prokurori që ka urdhëruar ekzekutimin e vendimit.

4. Komisioni i pritjes bën regjistrimin e të burgosurit në regjistrin e komisionit të pritjes.

Neni 13

Njohja me të drejtat dhe detyrimet

I burgosuri, pas verifikimit të dokumentacionit të pranimit nga komisioni i pritjes, njihet në një gjuhë që ai e kupton ose njeh, për të drejtat dhe detyrimet e tij, sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve.

Neni 14

Vlerësimi i riskut

1. Menjëherë pas njohjes me të drejtat dhe detyrimet e tij, për çdo të burgosur bëhet vlerësimi paraprak i nevojave psikologjike, shëndetësore dhe të sigurisë.

2. Për çdo të burgosur, brenda 10 (dhjetë) ditëve të qëndrimit në vëzhgim, kryhet vlerësimi i riskut. Vlerësimi i riskut përfshin:

- a) rrezikun e arratisjes dhe pasojat që mund të sjell për publikun;
- b) rrezikun për sigurinë, rendin, jetën e të tjerëve dhe të vetes; dhe
- c) çdo rrezik tjetër, që mund të ndikojë në realizimin e objektivave dhe misionit për rehabilitim.

3. Për vlerësimin e riskut, personeli i institucionit shqyrton, analizon dhe vlerëson çdo faktor risku apo nevoje, që ka mundësi të lidhet me sjelljen në institucion, si:

- a) historinë kriminale dhe sjelljen antisociale;
- b) paaftësinë e menaxhimit të emocioneve;
- c) agresivitetin;
- ç) kushtet e jetesës në institucion;
- d) konflikte të mundshme me të burgosur të tjerë;
- dh) probleme familjare;
- e) nivelin e edukimit, punësimin, kohën e lirë, shpenzimet financiare, qëndrimi i përhershëm ose ambienti ku banon;
- ë) probleme me substancat narkotike, psikotrope ose alkoolin;
- f) shëndetin mendor.

4. Format i formularit të vlerësimit të riskut miratohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

5. Mbështetur në rezultatet e vlerësimit të riskut, për të burgosurin hartohet planizimi i menaxhimit të riskut dhe ndërhyrjes.

6. Vlerësimi i riskut rishikohet në mënyrë periodike, por jo me pak se 1 (një) herë në vit.

Neni 15

Veprimet paraprake gjatë pranimit

1. Menjëherë pas pranimit në institucion, i burgosuri i nënshtrohet një vizite ekzaminuese dhe interviste mjekësore nga ana e mjekut dhe e psikologut, për njohjen e gjendjes shëndetësore fizike dhe psikologjike, me qëllim parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse në institucion apo vetëvrasjeve.

2. Shenjat e dëmtimeve fizike, të evidentuara në vizitën e pranimit, regjistrohen në një regjistër të veçantë, së bashku me shpjegimet rreth rrethanave të shkaktuara. Sektori shëndetësor njofton drejtuesin e institucionit, brenda 2 (dy) orëve nga konstatimi. Nëse ka të dhëna dhe fakte, që krijojnë bindjen e arsyeshme, se ndaj tij mund të jetë kryer veprë penale, njoftohen organet e procedimit penal, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale.

3. Mjeku, në rast se i kërkohet, e pajis të burgosurin e sapoardhur me një raport mjekësor, ku shpjegohet gjendja e tij shëndetësore. Një kopje e këtij raporti bëhet pjesë e kartelës mjekësore të të burgosurit të sapoardhur dhe vihet në dispozicion të tij.

4. Pas kontrollit shëndetësor, i burgosuri vendoset në seksionin e pranimit për një periudhë jo më të gjatë se 10 (dhjetë) ditë nga dita e pranimit të tij, ku nga komisioni i pritjes kryhen veprimet e mëposhtme:

- a) mbikëqyret gjendja shëndetësore dhe emocionale;
- b) realizohet njohja me të dhënat personale, familjare, arsimin, profesionin, veprën penale, shkakun e kryerjes së veprës penale dhe vlerësimin e riskut.

5. Të dhënat individuale të të burgosurit për personalitetin e tij vlerësohen bazuar në dokumentacionin shoqëruar, shpjegimet e dhëna, të dhënat e deklaruara në formularin e vlerësimit të riskut dhe raportin mjekësor të përgatitur. Bazuar në këto të dhëna, hartohet regjistri i komisionit të pritjes dhe përgatitet plani individual i trajtimit për të burgosurin.

6. Personeli i institucionit respekton të drejtën e të burgosurit, për të mos informuar familjarët apo persona të tjerë të ose me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes për qëndrimin e tij në institucion, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

Neni 16

Komisioni i pritjes

1. Në çdo institucion krijohet komisioni i pritjes për të pranuar të burgosurit. Komisioni informon të burgosurin në një gjuhë të kuptueshme dhe që njihet prej tij për rregulloren e institucionit, të drejtat dhe detyrimet, të drejtën për këshillim dhe ndihmë ligjore, si dhe rregullat e procedurat për paraqitjen e kërkesave dhe ankesave duke i vënë në dispozicion materialet përkatëse. Informacioni për të burgosurin jepet edhe në formë të shkruar.

2. Komisioni i pritjes përbëhet nga një përfaqësues i sektorit ligjor, një përfaqësues i sektorit të çështjeve shoqërore, një përfaqësues i shërbimit shëndetësor dhe një përfaqësues i shërbimit të sigurisë.

3. Komisioni i pritjes merr kontaktin e parë me të burgosurin dhe njihet me problemet, personalitetin, rrezikshmërinë e të burgosurit për sigurinë e të burgosurve të tjerë ose të personelit dhe e informon për mënyrën e jetesës gjatë kohës së qëndrimit në institucion.

4. Në regjistrin e komisionit të pritjes evidentohen të dhënat personale e familjare, arsimit, profesioni, vepra penale për të cilën akuzohet ose për të cilën është dënuar, konfliktet e mundshme dhe bëhen rekomandimet përkatëse, të cilat i paraqiten drejtorit të institucionit.

5. Në rastet kur evidentohet dhe shënohet në regjistrin e komisionit të pritjes, se i burgosuri ka konflikt apo mosmarrëveshje me të burgosur të tjerë ose ka lidhje gjinie a krushqie me personelin e institucionit, në pamundësi sistemimi merren menjëherë masa për transferimin e tij në një institucion tjetër.

6. Komisioni i pritjes mblidhet jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga pranimi i të burgosurit ose menjëherë kur për shkak të gjendjes shëndetësore apo të rrethanave të tjera, është i detyrueshëm përshpejtimi i procedurave të pranimit.

Neni 17

Sistemimi i të burgosurit

1. I burgosuri qëndron në dhomën e pranimit jo më shumë se 10 (dhjetë) ditë dhe më pas vendoset në mjedisin e banimit. Në vendosjen e të burgosurit nëpër mjediset e banimit mbahen parasysh kriteret, që lidhen me vlerësimin e riskut, gjendjen gjyqësore, faktin nëse janë ose jo përsëritës, llojin e veprës penale, masën e dënimit, moshën, gjendjen shëndetësore dhe nevojat mjekësore, arsimin, veçoritë intelektuale dhe psikike, kërkesat e veçanta për trajtimin e tij, problemet konfliktuale, fakti nëse është nën hetim për të njëjtën çështje penale me persona të tjerë të ndaluar me urdhër të prokurorit apo të gjykatës.

2. Përpara se i burgosuri të sistemohet në mjedisin e banimit, veçanërisht kur ai vendoset në mjedis me të burgosur të tjerë, bëhet vlerësimi i riskut për ndarjen e mjedisit së banimit.

3. Ndalohet mbajtja e të burgosurve të mitur në një mjedis me të rriturit apo vendosja e të burgosurve me gjini të ndryshme në të njëjtin mjedis. Të dënuarit e mitur, nën moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, vendosen në institucione të veçanta për të dënuarit e mitur dhe të paraburgosurit e mitur vendosen vetëm në seksionin për të mitur në mjediset e paraburgimit, veçmas nga të paraburgosurit e rritur, duke iu krijuar mundësi për një trajtim të veçantë. Të rinjtë e moshës nga 18 deri 21 vjeç, që akuzohen për kryerjen e një vepre penale, kur kanë qenë të mitur, mbahen në seksione të veçanta nga të burgosurit e tjerë të rritur.

4. Gratë e burgosura vendosen në institucione për gra dhe mbahen nën mbikëqyrjen dhe kujdesin e personelit femëror.

Neni 18
Dosja personale

1. Për çdo të burgosur hapet dosja personale, plotësimi i së cilës fillon nga momenti i pranimit në institucion dhe vazhdon deri në lirimin e tij.
2. Dosja e shoqëron të burgosurin në rast transferimi në çdo institucion tjetër.
3. Me përfundimin e kryerjes së dënimit ose në rast lirimi, dosja arkivohet në institucion.

Neni 19
Regjistrat dhe dosjet në institucion

1. Institucioni krijon dhe administron regjistrat dhe dosjet, si më poshtë vijon:
 - a) regjistrin themeltar të të dënuarve;
 - b) regjistrin themeltar të të paraburgosurve;
 - c) dosjen personale të të burgosurit;
 - ç) sistemin elektronik të të dhënave;
 - d) dosjen psikosociale;
 - dh) kartelën klinike shëndetësore dhe stomatologjike;
 - e) regjistrin e kërkesë-ankesave;
 - ë) regjistrin e shkeljeve dhe masave disiplinore;
 - f) regjistrin e lirimeve para kohe me kusht;
 - g) regjistri e lejeve të të burgosurve;
 - gj) regjistrin e ngjarjeve të rënda;
 - h) regjistrin e uljeve të dënimit;
 - i) regjistrin e vizitave mjekësore;
 - j) regjistrin e aktivitetit 24-orësh;
 - k) regjistrin e punësimit;
 - l) regjistrin e komisionit të pritjes;
 - ll) regjistrin e dokumentimit të rasteve të ushtrimit të dhunës;
 - m) regjistrin e kontrollit të ushqimit;
 - n) regjistrin e indeksit alfabetik;
 - nj) regjistrin e kufizimit fizik dhe mjekimit të detyruar për personat që kanë çrregullime të shëndetit mendor;
 - o) regjistrin e raporteve të informacioneve inteligjente për përdorim të kufizuar, në përputhje me legjislacionin për sekretin shtetëror ose hetimor;
 - p) regjistra të regjimit të posaçëm dhe mbikëqyrjes së veçantë;
 - q) regjistrin e riskut.
2. Me përjashtim të regjistrit të parashikuar në shkronjën “dh”, të pikës 1, të këtij neni, administrimi, forma dhe përmbajtja e regjistrave, miratohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

KREU IV
TË DREJTAT E TË BURGOSURVE DHE KUSHTET E JETESËS NË INSTITUCION

Neni 20
Të drejtat e të burgosurve

1. Gjatë qëndrimit në institucion, të burgosurit, me përjashtim kur parashikohet ndryshe për kategori të veçanta, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kanë të drejtat, si më poshtë vijon:

- a) u sigurohet takimi, korrespondenca, bisedat telefonike me avokatët duke pasur kohë të mjaftueshme dhe në konfidencë të plotë;
 - b) e drejta e informimit për të drejtat e tyre;
 - c) u sigurohet fjetje në krevat të veçantë me rroba fjetjeje, sipas kushteve klimaterike, si dhe ndriçim të përshtatshëm;
 - ç) u sigurohet ushqim 3 (tre) herë në ditë, sipas normave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore, për trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve;
 - d) të kenë llogari bankare personale, të cilën mund ta përdorin për nevojat e tyre;
 - dh) të takohen me anëtarët e familjes ose me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes;
 - e) t'u sigurohet shërbimi i kujdesit shëndetësor 24 (njëzet e katër)-orësh, nën kujdesin e personelit shëndetësor të institucionit apo të kryejë vizita mjekësore nga një mjek dhe/ose në një institucion shëndetësor brenda vendit, me kushtin që t'i mbulojë vetë shpenzimet mjekësore dhe çdo shpenzim tjetër, që rrjedh si pasojë e zgjedhjes së mjekut prej tij. Për rastet e sëmundjeve ngjithëse ose të sëmundjeve të tjera, diagnostikimi dhe mjekimi i të cilave nuk mund të sigurohen në kushtet e institucionit, i burgosuri transferohet në qendrën spitalore të burgjeve dhe, kur është e nevojshme, transferohet në Qendrën Spitalore Universitare Tiranë ose në institucionet spitalore rajonale në varësi të saj;
 - ë) të paraqesin kërkesa dhe ankesa te personeli i institucionit dhe pranë çdo institucioni tjetër;
 - f) t'u sigurohet e drejta dhe fshehtësia e korrespondencës;
 - g) e drejta e bisedave telefonike;
 - gj) e drejta e ajrimit;
 - h) të marrin pjesë në aktivitete argëtuese dhe edukative, që organizohen nga institucioni;
 - i) e drejta e punësimit dhe punës, për sa është e mundur;
 - j) e drejta e lirisë së besimit dhe ushtrimit të rriteve fetare;
 - k) e drejta e ndihmës social-psikologjike;
 - l) e drejta e përdorimit të sendeve personale të lejuara, sipas parashikimeve në këtë rregullore; si dhe
 - ll) çdo e drejtë tjetër e parashikuar në legjislacionin në fuqi.
2. Shtetasit e huaj kanë të drejtë të marrin kontakte me përfaqësitë diplomatike të vendit të tyre dhe gëzojnë të njëjtat të drejta dhe detyrime me të burgosurit e tjerë, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë rregullore.

Neni 21

Shërbimet e kujdesit shëndetësor

1. Shërbimi i kujdesit shëndetësor ofrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve gjatë të gjithë kohës së qëndrimit në institucion dhe mbulohet nga sigurimi i detyrueshëm i kujdesit shëndetësor, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve, dhe akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.
2. Trajtimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor bëhet sipas legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve dhe legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor.
3. I burgosuri që ka probleme shëndetësore i paraqet kërkesën me shkrim ose me gojë për vizitë ekzaminuese personelit mjekësor ose personelit të sigurisë. Personeli shëndetësor i turnit, harton listën përkatëse dhe ia dorëzon mjekut të institucionit për të bërë ekzaminime, me përjashtim të rasteve urgjente.
4. Lëvizja e të burgosurit nga mjedisi i banimit për në infermieri dhe anasjelltas, me përjashtim të rasteve urgjente, bëhet një nga një, sipas kërkesës së mjekut. Gjatë konsultës dhe ekzaminimeve mjekësore, i burgosuri qëndron i paprangosur dhe punonjësi i sigurisë qëndron jashtë dhomës deri në mbarimin e vizitës.

5. I burgosuri nuk mund të mbajë apo të përdorë medikamente mjekësore pa miratimin e personelit mjekësor, përveç rasteve kur trajtimi është miratuar nga mjeku i familjes së të burgosurit apo mjeku specialist jashtë institucionit.

6. I burgosuri është i detyruar të zbatojë udhëzimet e personelit shëndetësor gjatë terapisë. Në rast refuzimi për kryerjen e terapisë, personeli mjekësor e dokumenton këtë fakt me shkrim. Personeli i institucionit ndalohet të detyrojë të burgosurin t'i nënshtrohet çdo lloj trajtimi mjekësor nëpërmjet forcës, përveç rasteve kur i burgosuri ka çrregullime të shëndetit mendor dhe është marrë miratimi i anëtarëve të familjes apo kujdestarit.

7. Refuzimi i të burgosurit për të marrë medikamente apo për të kryer ekzaminime dokumentohet në një procesverbal të nënshkruar prej tij dhe punonjësve të institucionit të ekzekutimeve të vendimeve penale dhe në rast se, i burgosuri nuk pranon të nënshkruajë procesverbalin, ky dokument nënshkruhet nga më shumë se një punonjës dhe administrohet në dosjen e të burgosurit me numër protokoll të brendshëm, në mënyrë që të evidentohet në kohë kryerja e veprimit.

Neni 22

Shërbimi stomatologjik

1. Të burgosurit i ofrohet shërbim apo trajtim stomatologjik në institucion.
2. I burgosuri ka të drejtë, që me mjetet e tij financiare, të trajtohet në klinika stomatologjike jashtë institucionit.

Neni 23

Shërbimi shëndetësor farmaceutik

1. Pas vizitave ekzaminuese, mjeku i institucionit ose mjeku specialist sipas llojit të sëmundjes së të burgosurit, përcakton mjekimin e nevojshëm, që shënohet në regjistrin e vizitave mjekësore dhe kartelën klinike shëndetësore, si dhe i jep rekomandimet përkatëse personelit shëndetësor për veprime të mëtejshme.

2. Farmacia e institucionit menaxhon medikamentet mjekësore, ndërsa personeli shëndetësor realizon shpërndarjen e tyre.

3. Më miratimin dhe udhëzimin e mjekut të institucionit, të burgosurit mund t'i lejohet trajtimi me medikamente mjekësore, të siguruara me shpenzimet e tij.

Neni 24

Izolimi mjekësor

1. I burgosuri, që dyshohet ose ka sëmundje ngjitëse, izolohet menjëherë në mjedise të posaçme dhe trajtohet sipas standardeve të njëjta me personat e të njëjtës kategori jashtë institucionit, si dhe zbatohet legjislacioni në fuqi për parandalimin e epidemive.

2. Në rastet e konstatimit të sëmundjeve ngjitëse, mjedisi i banimit dezinfektohet, ndërsa i burgosuri vendoset në një mjedis të veçantë ose dërgohet në Qendrën Spitalore të Burgjeve për trajtim të specializuar.

3. Mjeku vendos për pushimin e izolimit, kur nuk ekzistojnë më shkaqet që çuan në vendosjen e izolimit.

Neni 25

Sendet personale dhe ruajtja e tyre

1. Të burgosurit i lejohej të mbajë veshje, sende të përdorimit personal ose objekte, që kanë një vlerë të veçantë morale ose personale.

2. Pas hartimit të procesverbalit të pranimit të të burgosurit, me dokumentet shoqëruese dhe sendet e tij personale, personeli përkatës organizon kontrollin e imtësishëm fizik dhe të materialeve personale të të burgosurit dhe në rast se konstaton sende që nuk lejohen të mbahen në institucion, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, i regjistron ato në librin përkatës dhe harton një procesverbal. Procesverbali nënshkruhet nga i burgosuri dhe punonjësi përgjegjës i institucionit, në prani të një punonjësi tjetër, ku një kopje e procesverbalit i jepet të burgosurit dhe kopja tjetër administrohet në arkivin e institucionit.

3. Sendet personale dhe vlerat monetare të të burgosurit i kthehen atij në momentin e lirimimit ose mund të tërhiqen në çdo kohë nga anëtarët e familjes ose nga persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes, sipas autorizimit të lëshuar nga i burgosuri, kundrejt procesverbalit të firmosur nga marrësi dhe nëpunësi i institucionit. Sendet që nuk mund të ruhen për shkak të cilësive, u dërgohen personave të autorizuar nga i burgosuri me shpenzimet e veta.

4. I burgosuri transferohet së bashku me sendet vetjake.

Neni 26

Sendet e ndaluara

1. Në mjediset e brendshme të institucionit nuk lejohej të mbahen dhe të qarkullohen nga të burgosurit:

- a) objektet, mbajtja e të cilave përbën vepër penale;
- b) sendet që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e të burgosurve dhe të personelit, si dhe sigurinë e institucionit;
- c) pajisje transmetimi dhe komunikimi, përfshirë aparatet celulare, pjesë të tyre dhe çdo lloj aksesori;
- ç) aparate filmuese dhe fotografike;
- d) vlera monetare të çdo lloji;
- dh) pajisje të njëjta me ato që ofrohen nga institucioni, të cilat janë pjesë e mjedisit të banimit apo e mjediseve të përbashkëta;
- e) sende me karakter diskriminues apo uniforma ushtarake;
- ë) bizhuteri, përveç atyre të lejuara sipas përcaktimeve të bëra në rregulloren e brendshme të institucionit;
- f) pije alkoolike;
- g) më shumë se një televizor në mjediset e banimit, sipas përcaktimeve të bëra në rregulloren e brendshme të institucionit.

2. Sendet e ndaluara të mbajtura nga i burgosuri, përveç rasteve kur mbajtja e tyre përbën vepër penale dhe konsiderohen si prova materiale, sekuestrohen dhe administrohen nga institucioni dhe i kthehen të burgosurit në momentin e lirimimit ose mund të tërhiqen në çdo kohë nga anëtarët e familjes apo persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes, sipas autorizimit të lëshuar nga i burgosuri, kundrejt procesverbalit të firmosur nga marrësi dhe nëpunësi i institucionit.

3. Për sendet, mbajtja e të cilëve përbën vepër penale dhe që konsiderohen provë materiale, ndiqen procedurat ligjore të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

Neni 27

Kontrolli intim për sende të ndaluara

1. Në rastet kur personeli i institucionit ka dyshime të arsyeshme se i burgosuri fsheh në trupin e tij sende të ndaluara, informon menjëherë drejtorin e institucionit, duke i paraqitur arsyet e dyshimit të krijuar dhe faktet e mundshme.

2. Kur shihet e arsyeshme, personeli e mban të burgosurin nën mbikëqyrje deri në përfundim të shqyrtimit të informacionit të përcjellë nga drejtori i institucionit.

3. Drejtori i institucionit, pasi shqyrton faktet dhe pretendimet e ngritura nga personeli i institucionit, nxjerr autorizimin për kontrollin intim të të burgosurit dhe ia përcjell njësisë përgjegjëse për shërbimin shëndetësor në institucion për të vijuar me kontrollin intim.

4. Njësia e shërbimit shëndetësor, pasi njihet me autorizimin e drejtorit të institucionit, kryen kontrollin intim të të burgosurit duke respektuar në çdo rast dinjitetin dhe integritetin e të burgosurit.

5. Personeli shëndetësor që kryen kontrollin intim, mban procesverbal mbi konstatimet e bëra gjatë kontrollit, i cili nënshkruhet në përfundim edhe nga i burgosuri.

6. Kontrolli intim mund të përligjet vetëm në rastet kur ka dyshim të arsyeshëm se i burgosuri mund të ketë fshehur sende të ndaluara dhe kryhen vetëm nga personeli shëndetësor, me autorizim të drejtorit të institucionit.

7. Kontrolli intim bëhet duke respektuar dinjitetin e të burgosurit.

8. Kontroll intim përbëjnë veprimet që lidhen me kontrollin apo ekzaminimin fizik në trup të të burgosurit.

9. Në të gjitha rastet, marrja e një objekti nga trupi i të burgosurit bëhet në mjedise të paeksponuara, të cilat kanë leje për ushtrimin e një veprimtarie mjekësore, me pjesëmarrjen e personelit shëndetësor me të njëjtën gjini.

10. Kontrolli intim i të miturve bëhet në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

Neni 28

Mjetet monetare

1. Nëse i burgosuri në momentin e ardhjes në institucion posedon mjete monetare, ato vendosen në llogarinë bankare të hapur në emrin e tij, përveç rasteve kur ai vendos ndryshe.

2. I burgosuri lejohet të përdorë llogarinë e hapur në emër të tij në një institucion bankar. Marrëdhëniet midis institucionit bankar dhe institucionit rregullohen me marrëveshje të përbashkëta, ku parashikohet mënyra e disponimit dhe përdorimit të mjeteve monetare nga të burgosurit.

3. Institucioni vë në dispozicion të të burgosurit shumën e parave për çdo muaj, e cila nuk mund të kalojë vlerën e gjysmës së pagës minimale mujore, sipas kërkesës dhe nënshkrimit të të burgosurit në rastin e mjeteve monetare personale apo të derdhura nga familjarët, si dhe jo më shumë se 40 (dyzet) për qind të pagës mujore në rastin kur i burgosuri është i punësuar. Mjetet monetare përdoren nga i burgosuri për blerje të sendeve, të cilat lejohen nga kjo rregullore ose rregullorja e brendshme e institucionit.

4. I burgosuri ka të drejtë t'i dërgojë mjete monetare familjes.

Neni 29

Veshjet, pajisjet e fjetjes dhe ndriçimi në mjediset e banimit

1. Të burgosurit i sigurohen shtresat, mbulesat për fjetje dhe veshje, në përputhje me kushtet klimaterike dhe nevojat e tij shëndetësore, sipas normave të miratuara në rregulloren e brendshme të institucionit.

2. Veshjet e të burgosurit mirëmbahen dhe zëvendësohen kur është e nevojshme.

3. Të burgosurit i lejohet të mbajë dhe të përdorë veshjet e veta personale, pasi sigurohet nga personeli i burgjeve se këto veshje nuk përbëjnë rrezik për vetë të burgosurin, të burgosurit e tjerë apo institucionin.

4. Veshja personale e të burgosurit nuk duhet të jetë denigruese ose përbuzëse, të cenojë normat morale apo imazhin e institucionit.

5. Gjatë natës ndriçimi i mjediseve të banimit mbahet i fikur. Në rast se vlerësohet e nevojshme dhe e domosdoshme, drita e mjedisit të banimit mund të mbahet e ndezur ose me ndriçim të zbehur.

6. Kuotat minimale për ndriçimin caktohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, sipas rekomandimeve të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

Neni 30

Koha e ajrimit të të burgosurve

1. Koha e ajrimit të të burgosurve në ambiente të hapura është nga ora 08:00 deri në orën 15:00, nga muaji mars deri në muajin maj, dhe nga muaji shtator deri në muajin nëntor. Nga muaji qershor deri në muajin gusht koha e ajrimit të të burgosurve në ambiente të hapura është nga ora 08:00 deri në orën 18:00 dhe nga muaji dhjetor deri në muajin shkurt koha e ajrimit është nga ora 08:00 deri në orën 14:00.

2. Kohëzgjatja maksimale e ajrimit sipas pikës 1, të këtij neni, përcaktohet nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, në varësi të nevojave të sigurisë, veprimtarive të përbashkëta, punësimit ose vetëpunësimit, nevojave edukative dhe shkaqeve të tjera sipas nevojave të institucionit.

Neni 31

Shërbimet higjienike

1. Të gjitha mjediset e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale duhet të mirëmbahen dhe të jenë të pastra.

2. Shërbimet higjienike në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale ndërtohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë kushtet normale për jetesë. Vendet ku kryhen këto shërbime pajisen me pajisjet hidro-sanitare të nevojshme dhe kanë ujë të rrjedhshëm.

3. Shërbimet higjienike vendosen në mjedise të veçanta, të ndara nga mjediset e tjera ku zhvillohen veprimtari të përbashkëta dhe në raporte të përshtatshme me numrin e të burgosurve.

Neni 32

Higjiena personale dhe e mjediseve

1. I burgosuri është i detyruar të kujdeset vazhdimisht për higjienën personale, si dhe të mirëmbajë dhe të pastrojë mjedisin e banimit, dhe mjediset e tjera të përbashkëta.

2. Detergjentët pastrues e dezinfektues, mjetet e nevojshme të tualetit, si dhe mjetet e tjera për pastrim sigurohen nga institucioni. Të burgosurit i lejohet që të sigurojë edhe vetë, me shpenzimet e tij, detergjentë pastrues e dezinfektues dhe mjete të tjera për pastrim, kur këto të fundit nuk përbëjnë rrezik për sigurinë në institucion dhe sigurinë e të burgosurve të tjerë.

3. Të burgosurit kanë akses të rregullt në mjediset sanitare, të cilat duhet të jenë të pastra dhe të respektojnë privatesinë.

4. Të burgosurit i sigurohen kushte të përshtatshme në mënyrë të tillë që të bëjë dush, me ujë në temperaturë të përshtatshme me klimën. Kur është e mundur, dushi mund të bëhet çdo ditë ose të paktën 3 (tre) herë në javë gjatë stinës së verës dhe 2 (dy) herë në javë gjatë stinës së dimrit ose më shpesh nëse është e nevojshme, në interes të higjienës së përgjithshme.

5. Kontrolli higjieno-sanitar i mjediseve të banimit dhe i mjediseve të përbashkëta bëhet çdo ditë nga personeli mjekësor, dhe specialisti i regjimit të brendshëm, të cilët lënë detyrat përkatëse për të metat e konstatuara dhe informojnë drejtorin e institucionit për gjendjen.

6. Për nevojat sanitare të grave përcaktohen rregulla të veçanta në rregulloren e brendshme të institucionit.

Neni 33

Pastrimi i mjediseve të banimit

1. I burgosuri duhet të mbajë pastër veshjet, shtresat e fjetjes, mjediset e banimit dhe mjediset e tjera të përbashkëta. Çdo institucion i ekzekutimit të vendimeve penale parashikon në rregulloren e brendshme mënyrën e hartimit të grafikut ditor të pastrimit të mjediseve të banimit dhe mjediseve të përbashkëta, rregullat e pastrimit dhe kontrollin e tyre.

2. Institucioni siguron ujin, detergjentët pastrues dhe dezinfektues, si dhe mjetet e tjera të nevojshme për pastrim.

Neni 34

Kërkesat dhe ankesat

1. I burgosuri ka të drejtë të paraqesë kërkesë ose ankesë sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve.

2. Kërkesa ose ankesa e të burgosurit regjistrohet në një regjistër të veçantë.

3. Çdo institucion mban dhe përditëson regjistrin e kërkesave ose ankesave të të burgosurve, në formë shkresore dhe elektronike. Formatu dhe përmbajtja e regjistrit është sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje dhe pjesë përbërëse e saj.

4. Kërkesa ose ankesa, pasi regjistrohet në regjistër i dorëzohet drejtorit të institucionit, i cili ngarkon punonjës të përgjegjës për trajtimin e saj dhe kthimin e përgjigjes të burgosurit.

5. Punonjësi përgjegjës i ngarkuar nga drejtori i institucionit trajton kërkesën ose ankesën në përputhje me rregullat dhe afatet e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

6. Në rastin kur kërkesa ose ankesa i drejtohet organeve publike, organizatave jofitimprurëse apo subjekteve të tjera shqiptare apo të huaja, institucioni i krijon të burgosurit mundësinë për përcjelljen e kërkesës ose ankesës, si dhe përgjigjen përkatëse, nëse ka, duke garantuar të drejtën e konfidencialitetit të korrespondencës, sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, dhe në këtë rregullore.

Neni 35

Raporti individual i vlerësimit

1. I dënuari me burgim, në përputhje me parashikimet e Kodit Penal, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për lirim me kusht në gjykatën e vendit të ekzekutimit të dënimit. Pas paraqitjes së kërkesës nga gjykata, drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale paraqet në gjykatë një kopje të dosjes personale të të dënuarit dhe një raport individual vlerësimi për të.

2. Në raport përcaktohen qëndrimi i të dënuarit ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës, ndonjë vepër e mëparshme penale e kryer prej tij, rrezikshmëria për përsëritjen e veprës penale, rrethanat familjare dhe shoqërore, formimi arsimor e profesional, gjendja fizike dhe psikologjike e të dënuarit, si dhe dinamika e sjelljes së tij në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penal.

3. Raporti individual i vlerësimit hartohet nga punonjësi përgjegjës për sektorin ligjor, punonjësi përgjegjës për çështjet shoqërore dhe punonjësi përgjegjës për çështjet e sigurisë.

4. Formati i raportit individual të trajtimit miratohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

KREU V RREGULLAT E EKZEKUTIMIT TË DËNIMEVE ME BURGIM PËR GRATË DHE TË MITURIT

Neni 36

Vendosja në institucion dhe respektimi i të drejtave të grave

1. Gratë e burgosura vendosen në institucione për gra dhe mbahen në mbikëqyrjen, dhe kujdesin e personelit femëror.

2. Gratë e burgosura trajtohen duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore dhe pa diskriminim për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi, duke parandaluar çdo akt dhune me bazë gjinore, që sjell dëmtim fizik, seksual ose psikologjik, vuajtje ose çdo formë tjetër abuzimi e keqtrajtimi, të dënueshëm sipas legjislacionit në fuqi.

3. Mjediset e ekzekutimit të vendimeve penale për gratë janë të përshtatshme për të plotësuar nevojat e tyre, në përputhje me kërkesat e respektimit të shëndetit dhe dinjitetit, në funksion të rishoqërizimit, riintegritimit dhe rehabilitimit duke i ofruar kujdes, asistencë dhe mbikëqyrje.

4. Gratë e burgosura trajtohen duke marrë parasysh nevojat dalluese gjinore. Marrja parasysh e këtyre nevojave nuk konsiderohet si trajtim diskriminues.

Neni 37

Shërbimet e kujdesit shëndetësor për gratë e burgosura

1. Grave të burgosura u ofrohen programe dhe shërbime specifike në përputhje me nevojat e tyre. Ato informohen me një gjuhë të kuptueshme për kujdesin shëndetësor, për parandalimin e sëmundjeve të ndryshme, për higjienën vetjake, për format e dhunës dhe për çdo lloj abuzimi.

2. Kujdesi shëndetësor i grave të burgosura ofrohet mbështetur në nevojat specifike gjinore dhe përfshin kontroll të plotë për të përcaktuar nevojat e kujdesit shëndetësor parësor, si dhe për aq sa është e mundur, ofrohet nga personel mjekësor i së njëjtës gjini.

3. Kontrolli mjekësor i grave të burgosura, përfshin një kontroll gjithëpërfshirës për të përcaktuar nevojat parësore të kujdesit shëndetësor, përfshirë këtu edhe kujdesin gjinekologjik dhe obstetrik, dhe gjithashtu duhet të përcaktojë:

a) praninë e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme ose sëmundjeve të mbartura nëpërmjet gjakut;

b) nevojat e kujdesit të shëndetit mendor, duke përfshirë çrregullimin e stresit posttraumatik dhe rrezikun e vetëdëmtimit dhe/apo vetëvrasjes;

c) ekzistencën e varësisë nga substancat narkotike apo psikotrope ose alkooli;

ç) abuzimin seksual dhe format e tjera të dhunës, të pësuar para pranimit.

4. Në varësi të faktorëve të riskut, grave të burgosura u ofrohen teste për HIV-in, me këshillim para dhe pas testit.

5. Grave të burgosura që kanë përjetuar dhunë fizike, psikologjike apo seksuale u ofrohen programe të kujdesit shëndetësor për trajtimin dhe rehabilitimin e tyre.

6. Grave të burgosura u sigurohet kontroll periodik nga mjeku gjinekolog, mjeku psikiatër dhe kontrolle periodike për parandalimin dhe diagnostikimin e sëmundjeve të kancerit të gjirit, dhe sëmundjeve të tjera për gratë.

7. Gratë e burgosura shtatzëna dhe gratë e burgosura të sapolindura ndihmohen dhe trajtohen në qendra të specializuara të obstetri-gjinekologjisë jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, gjatë periudhës së shtatzënisë, gjatë dhe pas lindjes.

8. Ndihma mjekësore për fëmijët e nënave të burgosura jepet nga strukturat përgjegjëse të shëndetit publik.

9. Trajtimi i grave të burgosura me çrregullime të shëndetit mendor sigurohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor, legjislacionit për trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

10. Gruaja e burgosur që ka çrregullime të shëndetit mendor gëzon të drejtën për trajtim të veçantë shëndetësor pranë strukturave shëndetësore të specializuara për trajtimin e sëmundjeve të shëndetit mendor ose në qendrën spitalore të burgjeve, sipas rastit.

Neni 38

Pranimi i grave të burgosura me fëmijë deri në 3 (tre) vjeç

1. Grave të burgosura me fëmijë deri në 3 (tre) vjeç, për shkak të situatës së veçantë të tyre, u kushtohet një vëmendje e veçantë gjatë procedurave të pranimit në institucion.

2. Sistemimi i gruas së burgosur dhe fëmijës së saj bëhet në seksione të veçanta për nënat me fëmijë brenda institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale. Institucioni përgatit kushte të veçanta për ushqimin nga një personel i kualifikuar, gjatë kohës që fëmijës i duhet të qëndrojë me personelin përkatës kur prindi është i përfshirë në veprimtari në të cilat i fëmija nuk duhet të jetë i pranishëm.

3. Komisioni i pritjes, gjatë pranimit në institucion të grave me përgjegjësi përkujdesjeje për fëmijë të kësaj grupmoshe, duke marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës, e vendos menjëherë nënën e burgosur së bashku me fëmijën e saj në seksionin e veçantë brenda institucionit për gratë.

4. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga vendosja në seksionin e veçantë të gruas së burgosur dhe fëmijës së saj, komisioni i pritjes vlerëson të dhënat individuale të gruas së burgosur për personalitetin e saj bazuar në dokumentacionin shoqërues, shpjegimet e dhëna prej saj, të dhënat e deklaruara në formularin e vlerësimit të riskut dhe raportit mjekësor të përgatitur sipas përcaktimeve ligjore.

5. Bazuar në të dhënat e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni, përgatitet plani individual i trajtimit për gruan e burgosur dhe plani i përkujdesjes për fëmijën e saj.

6. Në seksionet e veçanta për nënat e burgosura me fëmijë, zbatimi i planit individual të trajtimit për nënën dhe përkujdesja ndaj fëmijës bëhet nga personel i kualifikuar.

Neni 39

Çerdhet e posaçme për fëmijët e grave të burgosura

1. Për kujdesin dhe asistencën ndaj fëmijëve deri 3 (tre) vjeç institucioni përgatit çerdhe të posaçme.

2. Këto çerdhe duhet të jenë të pastra, të ajrosura, të ngrohta dhe me të gjitha kushtet normale të çerdheve që gjenden jashtë institucionit.

3. Përkujdesja ndaj fëmijëve në këto çerdhe bëhet nga personel i kualifikuar.

4. Gjatë kohës që fëmija qëndron në çerdhe, nëna e tij vazhdon të zbatojë detyrat në përputhje me realizimin e planit individual të trajtimit.

5. Në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës, nëna e burgosur, në çdo kohë, shkëputet nga zbatimi i detyrave të planit individual të trajtimit dhe përkujdeset për fëmijën e saj së bashku me personelin e çerdhes apo të seksionit të veçantë ku ajo ndodhet.

Neni 40

Fëmija deri në 3 (tre) vjeç që ka nënën të burgosur

1. Të dhënat personale të fëmijës deri në 3 (tre) vjeç regjistrohen gjatë pranimit të gruas së burgosur në institucion. Regjistri përfshin të paktën emrin dhe moshën e fëmijës, si dhe të dhëna të tjera në bazë të legjislacionit në fuqi për të dhënat personale.

2. Për fëmijën deri në 3 (tre) vjeç, që nuk shoqëron nënën në institucion, regjistrohet vendndodhja dhe statusi i kujdestarisë.

3. I gjithë informacioni që lidhet me identitetin e fëmijës ruhet si konfidencial dhe përdorimi i këtij informacioni bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Drejtori i institucionit lejon që nënat e burgosura të përdorin rrobat personale për fëmijët e tyre. Në pamundësi për t'u pajisur me rroba personale, në përputhje edhe me interesin më të lartë të fëmijës, institucioni i siguron fëmijës të gjitha mjetet e nevojshme për një jetesë normale.

5. Vendimi për të larguar fëmijën nga nëna e burgosur para moshës 3 (tre) vjeç bëhet për arsye të ligjshme, në përputhje me Kodin e Familjes, Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, në rastet kur diktohet nga interesi më i lartë i fëmijës.

6. Kur fëmija arrin moshën 3 (tre) vjeçare ose kur largohet nga nëna para moshës 3 (tre) vjeç për arsye të ligjshme, sistemimi i tij bëhet sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi që rregullon marrëdhëniet familjare.

Neni 41

Shoqërimi i grave të burgosura jashtë institucionit

1. Shoqërimi i grave të burgosura jashtë institucionit kryhet nga personeli i së njëjtës gjini të grupeve të sigurisë dhe/ose forcave operationale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, duke respektuar dinjitetin e gruas që shoqërohet.

2. Shoqërimi i grave të burgosura bëhet mbi bazën e një plani masash të mirëpërcaktuara, në vlerësimin e riskut, në prova, të dhëna inteligjente, planin e bashkëveprimit me autoritete të rendit dhe sigurisë, duke harmonizuar mjete të përshtatshme dhe efikase për të garantuar vendimmarrje profesionale.

3. Gjatë shoqërimit tregohet kujdesi i duhur për ta ekspozuar sa më pak të burgosurën në publik dhe duke marrë masa mbrojtëse për të siguruar anonimatën.

4. Në të gjitha rastet, shoqërimi i të burgosurës bëhet me dokumentacionin përkatës.

Neni 42

Kontrolli personal i grave të burgosura

1. E burgosura i nënshtrohet kontrollit personal, kur ka dyshime të arsyeshme se mban sende të ndaluara, si dhe në çdo rast të hyrjes ose të daljes nga institucioni.

2. Kontrolli personal i të burgosurës bëhet në proporcion me nevojën që dikton kryerjen e tij dhe bëhet duke respektuar dinjitetin, besimin dhe veçori të tjera të saj.

3. Kontrolli i të burgosurës kryhet vetëm nga stafi me të njëjtën gjini, i trajnuar me metoda të përshtatshme kontrolli.

4. Kontrolli kryhet në praninë e jo më pak se 2 (dy) punonjësve femra, të cilat mbajnë procesverbal në lidhje me kontrollin e kryer.

5. Në çdo rast, ndalohet kontrolli intim ndaj të burgosurës nga punonjësja e Policisë së Burgjeve. Kontrolli intim bëhet vetëm nga personeli shëndetësor, me autorizim të drejtorit të institucionit, vetëm kur ka dyshim të arsyeshëm se e burgosura që kontrollohet mund të ketë fshehur sende të ndalura. Gjatë kontrollit intim asiston edhe një punonjëse femër, e cila mban procesverbal në lidhje me kontrollin e kryer.

6. Kontrolli intim i grave të burgosura bëhet sipas procedurave të parashikuara në nenin 27 të kësaj rregulloreje.

Neni 43

Vendosja në institucion dhe respektimi i të drejtave të të miturve

1. Të burgosurit e mitur vendosen në institucione për të mitur dhe, në pamundësi, në seksione të veçanta të institucioneve të tjera.
2. Të miturit vendosen në institucione që janë pranë vendbanimit të familjes së tyre apo institucioneve që shërbejnë për riintegrimin e tyre shoqëror.
3. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të miturit apo seksionet për të miturit sigurojnë lehtësi për të plotësuar nevojat individuale të të miturve të privuar nga liria.
4. Në mënyrë që të sigurohet mjedis i sigurt për të miturit në institucion apo seksion për ta, të miturit ndahen në bazë të grupmoshës, llojit dhe rëndësisë së veprës penale, zhvillimit fizik dhe mendor, si dhe karakteristikave të tjera duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të të miturit.
5. Të burgosurat e mitura vendosen veçmas nga të burgosurit e mitur.
6. Të burgosurit e mitur trajtohen duke respektuar liritë dhe të drejtat e tyre themelore. Trajtimi mbështetet në parimin e interesit më të lartë të fëmijës, të integritetit shoqëror, edukimit dhe parandalimit të rifutjes në krim.
7. Të miturve të privuar nga liria iu garantohen veprimtari dhe programe sipas një plani individual, që nxisin zhvillimin e tyre fizik dhe mendor, vetëvlerësimin, ndjenjën e përgjegjësisë dhe zhvillojnë tek ata sjellje dhe aftësi për parandalimin dhe kryerjen sërish të krimeve.
8. Të miturit e privuar nga liria nxiten të marrin pjesë në diskutimet për kushtet e përgjithshme dhe regjimin në institucione dhe të komunikojnë individualisht ose në grup, sipas rastit, me autoritetet për këto çështje.
9. Institucionet apo seksionet për të miturit ndërtohen ose organizohen për të përmbushur qëllimin rehabilitues nga privimi i lirisë, duke pasur parasysh të drejtën e të miturit për privatësi, stimulim shqisor, mundësi për shoqërim me të miturit e tjerë, pjesëmarrje në veprimtari sportive, ushtrime fizike dhe argëtim.
10. Të miturve të burgosur u sigurohet akses në shërbimet shoqërore, psikologjike dhe edukative, kujdesin fetar dhe programet argëtuese ose programe të tjera ekuivalente me to që janë të disponueshme për fëmijët në komunitet.
11. Çdo i burgosur që është i mitur dhe është subjekt i arsimit të detyrueshëm i sigurohet arsimimi, në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, legjislacionin për trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim.

Neni 44

Personeli në institucionet për të mitur

1. Personeli në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur apo seksionet e veçanta përzgjidhet me kujdes në mënyrë që t'u sigurojë të miturve një rol dhe model pozitiv.
2. Personeli që punon me të miturit trajnohet në fushën apo çështjet e psikologjisë dhe mirëqenies së të miturve, si dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e të miturve.
3. Punonjësit socialë apo psikologët, të cilët punojnë me të miturit, duhet të plotësojnë, ndër të tjera, kriteret si më poshtë vijon:
 - a) të ketë formim universitar si punonjës social;
 - b) të ketë formim pasuniversitar ose përvojë pune në profesionin përkatës, jo më pak se 2 (dy) vjet;
 - c) të kenë trajnimin dhe certifikimin në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve;
 - ç) të mos jenë të dënuar me vendim të gjykatave shqiptare dhe/ose të huaja për vepra penale kundër personit, të kryera me dashje;

d) të mos jetë marrë ndaj tyre, nga gjykatat shqiptare dhe/ose të huaja, asnjë vendim që lidhet me masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje.

Neni 45

Pranimi në institucionin e të miturit

1. Në momentin e pranimit në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, të miturit informohen për rregulloren e brendshme të institucionit dhe për të drejtat dhe detyrimet e tij në një gjuhë që kuptojnë ose njohin.

2. Për të burgosurit e mitur që nuk dinë shkrim e lexim, komunikimi i akteve bëhet në mënyrë verbale nga personeli përgjegjës, sipas shërbimeve të specializuara. Në rastet kur fëmija nuk dëgjon ose nuk flet, i garantohet interpretues i gjuhës së shenjave.

3. Çdo veprim procedural i kryer në lidhje me të miturin bëhet në prani të mbrojtësit, përfaqësuesit ligjor dhe psikologut.

4. Njoftimi i vendosjes së të miturit në institucion, si dhe informimi mbi rregulloren e institucionit apo çdo informacion tjetër i nevojshëm, i jepet menjëherë prindërve apo përfaqësuesit ligjor të të miturit.

5. Menjëherë pas pranimit në mjediset e institucionit, brenda 24 (njëzet e katër) orëve, çdo i mitur i nënshtrohet një vizite ekzaminuese nga një mjek, me qëllim identifikimin dhe regjistrimin e ndonjë shenje apo të dhëne, keqtrajtimi të mëparshëm ose dëmtimi fizik apo mendor që kërkon kujdes mjekësor. Pas ekzaminimit të të miturit, mjeku përgatit një raport, në të cilin përshkruan faktin nëse tek i mituri konstatohen ose jo shenja apo të dhëna, keqtrajtime ose dëmtime fizike a mendore.

6. Brenda 24 (njëzet e katër) orëve për të miturin hapet kartela mjekësore, ku regjistrohet trajtimi i sëmundjeve apo dëmtimeve. Në regjistrin e kontrollit shëndetësor, në kohën e pranimit shënohet me saktësi, data dhe ora e kontrollit dhe i mituri nënshkruan. Ky kontroll përfshin edhe kontrollin për sëmundjet ngjitëse.

7. Çdo i mitur intervistohet jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga momenti i pranimit, nga një psikolog ose punonjës social, i cili përgatit një raport psikologjik dhe social, në të cilin të identifikohet dhe përshkruhet çdo faktor që lidhet me llojin dhe nivelin e kujdesit, dhe programit që nevojitet për trajtimin e të miturit.

8. Raportet e përmendura në pikat 4 dhe 6, të këtij neni, i jepen drejtorit të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur, i cili përcakton nivelin e përshtatshëm të sigurisë, që mund të rishikohet më pas dhe llojin e programit individual për të.

9. Me përjashtim të rasteve kur periudhat e privimit të lirisë janë shumë të shkurtra, për çdo të mitur hartohet një program arsimimi dhe trajnimi në përputhje me karakteristikat individuale të të miturit brenda 4 (katër) javëve nga koha e pranimit në institucion, duke marrë mendimet e të miturit. Në mungesë të përfundimit të një programi të plotë, drejtori i institucionit merr masa që i mituri të fillojë programin shkollor në mënyrë të menjëhershme.

Neni 46

Klasifikimi dhe vendosja nëpër mjediset e banimit

1. I mituri ka të drejtë të ketë një shtrat individual në një mjedis banimi të veçantë, përveç kur konsiderohet e nevojshme për të miturin për të ndarë të njëjtin mjedis banimi, i cili mund të mbikëqyret pa krijuar shqetësim. Në çdo institucion ku vendosen të mitur, ngrihet dhe funksionon një sistem vlerësimi për klasifikimin e të miturve në përputhje me nevojat e tyre shëndetësore, edukuese, zhvillimore dhe të sigurisë.

2. Kriteri kryesor për klasifikimin e kategorive të ndryshme të të miturve është lloji i përkujdesjes që i përmbush më mirë nevojat individuale të një të mituri, si dhe mbrojtja e integritetit dhe mirëqenies së tyre fizike, mendore e morale.

3. Personeli i institucionit garanton mbikëqyrje të rregullt dhe të fshehtë të të gjithë mjediseve të banimit, veçanërisht gjatë natës, për të siguruar mbrojtjen e çdo të mituri.

Neni 47

Higjiena dhe kushtet e jetesës

1. Drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale merr masa që institucioni për të mitur të mirëmbahet dhe të jetë i pastër në çdo kohë.

2. Të miturit kanë akses të menjëhershëm në tualete dhe dushe, të cilat duhet të jenë të pastra dhe të respektojnë privatësinë e tyre.

3. Të miturve u garantohej e drejta për të bërë dush individual, nëse është e mundur, çdo ditë, me ujë të ngrohtë, pavarësisht temperaturës së mjedisit.

4. Të miturit ruajnë higjienën vetjake, të veshjeve dhe të mjediseve të tyre të banimit. Drejtori i institucionit merr masa që të miturve t'u mësohet si të veprojnë për ruajtjen e higjienës.

5. Kushtet e jetesës janë në përputhje me moshën, gjendjen dhe nevojat e veçanta të të miturit. Institucioni siguron që të dënuarit e mitur të lëvizin në mënyrë të pavarur në territorin e institucionit, sipas rregullave të përcaktuara në programin ditor dhe në planin individual të ekzekutimit të dënimit.

6. Shtrati individual i të miturit të jetë i përshtatshëm në raport me moshën dhe karakteristikat fizike, i pastër dhe i përshtatshëm me klimën.

7. I mituri ka të drejtë të ketë një dollap për vendosjen e sendeve personale dhe mjedise të përshtatshme sanitare që janë higjienike dhe respektojnë nevojat e jetës private dhe të veçanta, gjinore, të të miturit.

8. I mituri i dënuar lejohet të veshë rrobat e veta, me kusht që ato të jenë të përshtatshme dhe në përputhje me rregulloren e brendshme të institucionit. Nëse i mituri ka marrë leje për t'u larguar nga vendi i vuajtjes së dënimit, veshja e tij nuk duhet ta identifikojë atë si një të dënuar.

Neni 48

Parandalimi i dhunës ndaj të miturve dhe trajtimi i viktimave

1. Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale merr masa dhe tregon kujdes të veçantë për nevojat e të miturve që kanë përjetuar dhunë fizike, psikologjike ose seksuale, si dhe për parandalimin e dhunës ndaj të miturve në institucion.

2. Institucioni merr masat e mëposhtme:

a) kujdeset që të gjitha ndërhyrjet e planifikuara nga grupet e ndërhyrjes speciale të regjistrohen në video;

b) në asnjë rast nuk vendos një të mitur të privuar nga liria, në pozicionin e ushtrimit të autoritetit ndaj të miturve të tjerë;

c) në rast të pretendimeve për ushtrim dhune nga një punonjës i policisë së burgjeve, merren masa të menjëhershme, të cilat e shmangin nga kontaktet e drejtpërdrejta me të miturin, derisa të përfundojë procesi i vlerësimit të këtyre pretendimeve;

ç) nëse një i mitur i burgosur pretendon se ndaj tij është ushtruar dhunë nga të burgosur të tjerë, ky i mitur vendoset në një akomodim alternativ apo kryen ajrimin duke shmangur kontaktet e drejtpërdrejta me të burgosurin që pretendohet se ka ushtruar dhunë, derisa të përfundojë procesi i vlerësimit të pretendimeve.

Neni 49

Detyrat e mjekut në rast të dëmtimeve traumatike të të miturit

1. Në rast se konstatohen dëmtime traumatike, mjeku pranë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale regjistron konstatimet e bëra gjatë kontrollit mjekësor në një procesverbal të veçantë. Ky procesverbal mbahet në kartelën mjekësore të të miturit.

2. Në këtë procesverbal, mjeku shënon:

- a) përshkrime të hollësishme për pjesët e trupit ku konstatohen dëmtimet traumatike;
- b) deklarin e bërë nga i mituri gjatë kontrollit mjekësor, ku përfshihet përshkrimi për gjendjen shëndetësore dhe çdo pretendim për keqtrajtime;
- c) një përshkrim të hollësishëm të ekzaminimit objektiv të kontrollit shëndetësor;
- ç) përfundimet e kontrollit mjekësor, të cilat tregojnë shkallën e përputhshmërisë ndërmjet pretendimeve të ngritura nga i mituri dhe evidentimit të shenjave.

3. Personeli shëndetësor fotografon dëmtimet e konstatuara, të cilat vendosen në dosjen mjekësore të të miturit.

4. Një kopje e procesverbalit i jepet të miturit, prindit ose kujdestarit, si edhe mbrojtësit të tij ligjor. Në çdo rast marrësi i procesverbalit nënshkruan për njoftimin.

5. Në rast se vëren dëmtime traumatike të të miturit, mjeku e referon menjëherë të miturin te psikologu i institucionit.

6. Mjeku i raporton menjëherë drejtorit të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale dhe prokurorit për të gjitha rastet e dëmtimeve traumatike të të miturve, pavarësisht se nga çfarë janë shkaktuar.

Neni 50

Plani individual i trajtimit dhe realizimi i tij

1. Për çdo të mitur të privuar nga liria hartohet një plan individual trajtimi, duke marrë në konsideratë vlerësimin psikologjik, situatën emocionale, nivelin arsimor, dëshirat dhe mundësitë e tij për të ndjekur kurse profesionale ose për të përparuar në arsimim. Ky plan individual trajtimi realizohet në bashkëpunim me të miturin.

2. Përgjegjës për zbatimin e planit individual caktohet një punonjës social.

3. Plani i trajtimit përfshin, ndër të tjera:

- a) arsimimin;
- b) kurse profesionale;
- c) trajnim për aftësim social;
- ç) edukim qytetar;
- d) menaxhim të agresionit apo zemërimit;
- dh) terapi kundër varësisë nga substancat narkotike/psikotrope apo alkooli;
- e) terapi individuale apo në grup;
- ë) edukim fizik dhe sporte;
- f) programe të drejtësisë restauruese dhe riparuese për veprën penale të kryer;
- g) aktivitetet krijuese të kohës së lirë;
- gj) veprimtari jashtë institucionit në komunitet, dhënia e lejeve ditore apo formave të tjera të lejeve;
- h) përgatitja për lirim dhe riintegrim.

4. Plani i trajtimit zbatohet dhe përditësohet rregullisht me pjesëmarrjen e të miturit, të mësuesve dhe atë që është e mundur të prindit dhe të përfaqësuesit ligjor.

5. Programi ditor parashikon që të miturit të kalojnë sa më shumë orë të munden jashtë mjediseve të banimit dhe atë që janë të nevojshme për një nivel të përshtatshëm ndërveprimi social.

6. Vëzhgimi, programi dhe realizimi i trajtimit bëhen nga administrata e institucionit me anë të personelit të vet, në bashkëpunim me strukturat dhe institucionet shtetërore përkatëse.

7. Programet e mbikëqyrjes së të miturve të privuar nga liria hartohen, zhvillohen dhe realizohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës.

8. Kontributi i organizatave jofitimprurëse dhe individëve të veçantë nxitet dhe mbështetet nga administrata e burgjeve në realizimin e programit të trajtimit, pasi të jenë verifikuar dhe të konsiderohen si të përshtatshëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

9. Drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale merr masa që institucioni të organizojë veprimtari edhe gjatë fundjavave dhe ditëve të festave.

Neni 51

Organizimi i procesit të rehabilitimit

1. Trajtimi i të miturve të burgosur bëhet duke siguruar mjediset dhe mjetet e përshtatshme, në përputhje me personalitetin, arsimin, gjendjen social-ekonomike, prirjet dhe aftësitë që ata kanë, duke synuar rehabilitimin për riintegrimin e tyre në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike, dhe uljen e recidivizmit. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve zhvillon programe, të cilat synojnë rehabilitimin dhe riintegrimin e këtyre personave në shoqëri.

2. Përgatitja për riintegrim fillon gjatë kryerjes së dënimit e vijon dhe pas lirimit nga institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale.

3. Institucioni, në bashkëpunim me Qendrën e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, Shërbimin e Provës, punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës, institucionet vendore dhe organizatat jofitimprurëse hartojnë programe riintegrimi për të miturit në prag lirimi.

4. Për të burgosurit e mitur që i përkasin minoriteteve etnike dhe gjuhësore, të huajt dhe personat pa shtetësi, për aq sa është e mundur, mundësohen programe që respektojnë kulturën e tyre me qëllim rehabilitimin e tyre në kohë sa më të shpejtë dhe me efektivitet.

5. Për realizimin e rehabilitimit social dhe riintegrimin të të burgosurve, institucioni duhet të vërë në dispozicion të gjitha burimet e përshtatshme, duke realizuar përkrahjen morale, kualifikimin profesional, arsimimin, edukimin fizik, zhvillimin e aftësive shoqërore, këshillimin, pjesëmarrjen në aktivitete të përbashkëta për të miturin dhe nxitjen e kontakteve me jashtë, në mënyrë që të zgjerohet perspektiva e riintegrimin shoqëror pas lirimit.

6. Trajtimi i të miturve të burgosur bëhet nga një personel i trajnuar në vazhdimësi për çështjet e të miturve.

7. Me qëllim rehabilitimin e të miturve hartohet plani individual i trajnimit, i cili bëhet duke vlerësuar nevojat individuale psikologjike, shoqërore, gjinore, moshën, gjendjen shëndetësore, orientimin seksual ose identitetin gjinor, situatën kulturore dhe ekonomike, mjedisin ku ka jetuar i mituri, veprën penale dhe faktorët e riskut, dhe motivimin për t'u përfshirë në veprimtari që organizohen në institucion.

8. Planit përfshin këshillim, terapi, edukim, arsimim, formim profesional, punësim, shërbim bibliotekar, si dhe çdo shërbim tjetër të nevojshëm.

9. Punonjësi i shërbimit social diskuton me të miturin e burgosur planin dhe programin e individualizuar, dhe bën rivlerësimin dhe ndryshimin në përputhje me ecurinë e trajtimit.

Neni 52

Ajrimi i të miturve

1. Të burgosurit e mitur kanë të drejtë të qëndrojnë në ajrim jo më pak se 2 (dy) orë në ditë dhe të paktën 2 (dy) herë në ditë, përveç kohës për veprimtari social-edukative.

2. Kohëzgjatja maksimale e ajrimit, sipas pikës 1, të këtij neni, përcaktohet nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve në varësi të veprimtarisë social-edukative.

3. Në rastet kur të miturit janë të vendosur në institucion në seksione të veçanta nga të burgosurit e rritur, në çdo rast ajrimi për të miturit kryhet veçmas nga të rriturit.

4. Koha e ajrimit në ambientet e hapura kryhet në përputhje me parashikimet e nenit 30 të kësaj rregulloreje.

Neni 53

Takimet, vizitat, korrespondencat dhe informacioni

1. Personeli i institucionit e ndihmon të miturin në mbajtjen e kontakteve me familjarët dhe rrethin shoqëror duke iu siguruar atyre mjetet e nevojshme për mbajtjen e këtyre kontakteve.

2. I mituri i burgosur ka të drejtën për takime, vizita dhe korrespondencë në përputhje me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

3. I mituri ka të drejtë të bëjë kërkesë verbale për ushtrimin e së drejtës së takimeve, vizitave dhe korrespondencës. Në rast se i mituri nuk bën kërkesë, personeli kryesisht e riinformon për të drejtën për të mbajtur kontakt me familjen dhe rrethin shoqëror.

4. Familja dhe rrethi shoqëror, në rast se kërkojnë kontakt me të miturin, paraqesin kërkesë pranë institucionit. Në çdo rast merret pëlqimi i të miturit për realizimin e kontaktit.

5. Vizitat duhet të bëhen në kohë të përshtatshme për të miturit dhe familjarët e tyre.

6. Korrespondencat dhe vizitat mund të kufizohen dhe mbikëqyren për arsye të kryerjes së hetimeve, ruajtjes së rendit publik, sigurisë, parandalimit të veprave penale, por këto kufizime, përfshi kufizimet e veçanta të caktuara me vendim gjykate ose urdhër prokurori, duhet të lejojnë një nivel minimal kontaktesh.

7. Informacionet për vdekjen apo sëmundje serioze të familjarëve të afërm, u njoftohen të miturve menjëherë në mënyrë të përshtatshme dhe në prani të psikologut.

Neni 54

Transferimi i përkohshëm i të miturit në një vend tjetër

1. I mituri i burgosur mund të transferohet përkohësisht në një vend tjetër për të mitur, në qoftë se një masë e tillë është e domosdoshme për sigurinë e tij ose për sigurinë e të miturve të tjerë.

2. Kjo masë vendoset nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve në mënyrë të arsyetuar, në përputhje me legjisllacionin në fuqi për trajtimin e të burgosurve, ku specifikohet natyra e transferimit, kohëzgjatja e tij maksimale dhe arsyet e këtij transferimi.

3. Urdhri për transferim i njoftohet të miturit, prindit, kujdestarit ose përfaqësuesit të tij ligjor. Dokumentacioni i transferimit të të miturit në një institucion tjetër përmban edhe planin individual që i mituri ka ndjekur në institucionin nga i cili po transferohet.

4. I mituri, prindi, kujdestari ose përfaqësuesi ligjor i të miturit mund të paraqesin ankesë ndaj vendimit të transferimit.

5. Menjëherë pas transferimit, i mituri i nënshtrohet një ekzaminimi mjekësor nga mjeku i thirrur nga drejtori i institucionit.

Neni 55

Transferimi në institucionin e ekzekutimit të vendimit pas mbushjes së moshës 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç

1. I dënuari që mbush moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç nuk lejohet të qëndrojë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur dhe dërgohet në institucionin për të rriturit.

2. Vendi i vuajtjes së dënimit për të miturin e dënuar që ka mbushur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç është:

- a) institucioni i hapur kur i ka mbetur më pak se 6 (gjashtë) muaj burgim;
- b) institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së ulët kur i ka mbetur 5 (pesë) vjet burgim;
- c) institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së zakonshme për të gjitha rastet e tjera.

3. 1 (një) muaj para se i mituri të mbushë moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, drejtori i institucionit për të mitur i kërkon drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve që të përcaktojë institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale ku do të vuajë dënimin i mituri në vazhdim.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve vendos për vendin e vuajtjes së dënimit apo për institucionin e paraburgimit të paktën 10 (dhjetë) ditë përpara se i mituri të mbushë moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç.

5. Ditën kur i mituri mbush moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç bëhet transferimi i të miturit në institucionin e përcaktuar nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve në urdhrin e tij.

6. I mituri që transferohet pasi ka mbushur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç trajtohet nga personeli i kujdesit psikosocial, duke siguruar vijimësinë e programeve të zbatuara në institucionet për të miturit.

Neni 56

Format e motivimit nxitës për të miturin e dënuar

1. Kur i mituri tregon sjellje shumë të mirë, përfshirje në programet edukative dhe aktivitetet e zhvilluara në institucionin e ekzekutimit të vendimit penal për të mitur, drejtori i institucionit zbaton format e motivimit nxitës të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

2. Drejtori i institucionit arsyeton përzgjedhjen e formës së motivimit në përputhje me funksionin riedukues.

3. Sendet, të cilat mund t'i jepen të miturit të burgosur, sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, janë:

- a) libra;
- b) revista;
- c) video-lojëra;
- ç) materiale krijimtarie artistike;
- d) biçikleta ose pajisje të tjera sportive, të përshtatshme për ambientet e jashtme të institucionit.

KREU VI

TRAJTIMI I TË BURGOSURVE NË REGJIMIN E POSAÇËM

Neni 57

Trajtimi ndryshe i të burgosurve

1. Të burgosurit trajtohen në mënyrë të njëjtë, pa asnjë lloj diferencimi, me përjashtim kur trajtimi ndryshe i tyre është i përligjur për shkak të rrezikshmërisë që paraqet i burgosuri dhe të ketë për qëllim përmbushjen e funksionit rehabilitues.

2. Trajtimi ndryshe i të burgosurve zbatohet nëpërmjet seksioneve të regjimit të posaçëm në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë.

3. Regjimi i posaçëm hapet në seksione të institucioneve të sigurisë së lartë, që nuk ka asnjë lidhje dhe mundësi kontakti me seksionet e tjera.

4. Seksioni ku zbatohet regjimi i posaçëm miratohet me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

5. Rregullat e përgjithshme të kësaj rregulloreje zbatohen edhe për regjimin e posaçëm, nëse nuk ka një rregullim të posaçëm në lidhje me trajtimin e personave të vendosur në këtë lloj regjimi.

Neni 58

Procedurat e pranimit të të burgosurve në regjimin e posaçëm

1. Pranimi i të burgosurve në regjim të posaçëm bëhet në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje për pranimin në institucion.

2. Dosja personale e të burgosurit, që do të pranohet në regjimin e posaçëm, përveç dokumenteve të përmendur në nenin 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, duhet të përmbajë detyrimisht urdhrin e ministrit të Drejtësisë për vendosjen në regjimin e posaçëm. Verifikimi i plotë i dokumentacionit bëhet nga punonjësi përgjegjës për çështjet ligjore në institucion.

3. Pranimi i të burgosurve në regjimin e posaçëm bëhet nga komisioni i pranimit, brenda orarit zyrtar.

4. Drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, duhet të:

- a) sigurohet që shkresat me masat e marra të jenë të lexueshme në çdo pjesë të tyre;
- b) kontrollojë vijueshmërinë në faqet e fletëve të shkresës;
- c) vendosë vulën e institucionit në çdo fletë të shkresës;
- ç) sigurohet që kopja e shkresës që i jepet të burgosurit të jetë e vulosur në çdo fletë të saj;
- d) sigurohet që masat e marra të bëhen të ditura dhe të aplikohen duke filluar nga dita e marrjes së dijenisë.

Neni 59

Informimi i të burgosurit lidhur me regjimin e posaçëm, të drejtat dhe detyrimet

I burgosuri që pranohet në regjimin e posaçëm të sigurisë së lartë, informohet nga komisioni i pranimit për të drejtat e tij sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për trajtimin e personave të dënuar dhe të paraburgosur, lidhur me:

- a) vizitat me anëtarët e familjes ose me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes;
- b) sendet personale të lejuara;
- c) komunikimi në telefon me familjen;
- ç) kontrollin e korrespondencës;
- d) kërkesat dhe ankesat;
- dh) orarin e veprimeve;
- e) kohën e ajrimit;
- ë) dietën ushqimore;
- f) trajtimin shëndetësor;
- g) uniformën apo veshjet;
- gj) takimet me mbrojtësin;
- h) të drejtën e ankimit sipas ligjit;
- i) procedurën disiplinore;
- j) përfitimet që mund të ketë nga sjelljet pozitive dhe problemet që mund të krijohen nga sjellje dhe qëndrime negative.

Neni 60

Vlerësimi fillestar i nevojave dhe faktorëve të riskut për sistemimin

1. Të burgosurit e vendosur në regjimin e posaçëm i nënshtrohen vlerësimit fillestar të riskut në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

2. Punonjësit që bëjnë vlerësimin e riskut, bëjnë një vlerësim të dytë brenda 3 (tre) muajve nga vendosja në regjimin e posaçëm, duke përdorur kriteret e vlerësimit të riskut të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 61

Pajisjet e mjedisit të banimit, higjiena dhe sendet personale të të burgosurve

1. Të burgosurit në regjim të posaçëm sistemohen në mjedise banimi individuale.
2. Mjedisi i banimit në regjimin e posaçëm ka sipërfaqe jo më pak se 6 m² dhe kubaturë 9 m³.
3. Ndriçimi, drita artificiale dhe ngrohja në regjimin e posaçëm kanë të njëjtin standard me ato që zbatohen jashtë këtij regjimi.
4. Pajisjet e mjedisit të banimit janë një krevat i fiksuar me dyshek, një tavolinë dhe një karrige e fiksuar. Tualeti ka një WC, një lavaman, një rubinet i cili shkarkon jo më shumë se 150 (njëqind e pesëdhjetë) litra uji në ditë dhe një pasqyrë të fiksuar në mur me material të tillë që nuk cenon sigurinë në institucion.
5. Çelësi i dritave komandohet nga jashtë mjedisit të banimit. Llamba e ndriçimit është me skarë dhe e paarritshme nga i burgosuri.
6. Brenda në mjedisin e banimit vendoset një zile për të njoftuar punonjësit në rast nevoje. Njoftimi i përsëritur i punonjësit nëpërmjet ziles, pa shkak, përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor.
7. Pajisjet e pastrimit mbahen në mjedisin e banimit, ndërsa detergjentët për larjen dhe pastrimin jepen nga punonjësit e policisë kur është e nevojshme dhe nxirren jashtë mjedisit të banimit me përfundimin e pastrimit.
8. Të burgosurit i lejohet të mbajë në mjedisin e tij të banimit sendet personale si:
 - a) pastë dhe furçë për larje dhëmbësh;
 - b) pajisje tualeti, brisq rroje një përdorimesh dhe sapun rroje;
 - c) libra me karakter edukativ, të cilët nxirren jashtë mjedisit të banimit pas leximit;
 - ç) letër dhe mjet shkrimi, të cilat i jepen të burgosurit në rast se i kërkon dhe nxirren jashtë pas përfundimit të letrës;
 - d) një televizor me kanale të reduktuara dhe orare të kufizuara të monitoruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Neni 62

Ushqimi

1. Të burgosurit nuk i lejohet të marrë nga familjarët ushqime, pije, fruta apo ëmbëlsira.
2. Të burgosurit i garantohet ushqim nga institucioni në 3 (tre) vakte, sipas orarit të veprimeve.
3. Ushqimi, para se të shpërndahet, kontrollohet nga specialisti i informacionit dhe mjeku ose ndihmësmjeku. Procesi i shpërndarjes dhe kontrollit të ushqimit dokumentohet dhe kampionët e ushqimit ruhen.
4. Shpërndarja e ushqimit në të tri vaktet bëhet nga kuzhinieri, i shoqëruar nga jo më pak se 2 (dy) punonjës të sigurisë.
5. Shpërndarja e ushqimit bëhet me pajisje të institucionit. Pas konsumit të vaktit pajisjet merren nga kuzhinieri.

Neni 63

Ajrimi

1. Të burgosurit e kryejnë ajrimin në mënyrë individuale.

2. Koha e ajrimit në mjedise të hapura është jo më pak se 1 (një) orë në ditë dhe në çdo rast jo më shumë se 2 (dy) orë.

3. Nxjerrja e të burgosurit në ajrim bëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës të sigurisë, gjithnjë duke kryer kontroll trupor, me prekje dhe detektor, në dalje dhe në hyrje.

4. Gjatë kryerjes së ajrimit, të burgosurit, krahas mbikëqyrjes me kamera, mbikëqyren herë pas here, nga jo më pak se 2 (dy) punonjës të sigurisë.

Neni 64

Orari i veprimeve

Orari i veprimeve rregullohet me urdhër të drejtorit të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale.

Neni 65

Takimi me anëtarët e familjes apo persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes

1. Të burgosurit në regjimin e posaçëm kanë të drejtën e 1 (një) takimi në muaj, deri në 30 (tridhjetë) minuta, me anëtarët e familjes ose me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes.

2. Takimi me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes, për të dënuarit, lejohet me propozimin e drejtorit të institucionit dhe me miratimin e drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

3. I paraburgosuri mund të kryejë takim me persona të tjerë, pas miratimit nga prokurori, mbi bazën e kërkesës me shkrim të të paraburgosurit ose mbrojtësit të tij drejtuar drejtorit të institucionit. Drejtori i institucionit, pasi vlerëson faktet, i propozon prokurorit kryerjen e takimit.

4. I burgosuri deklaron në momentin e pranimit, në regjimin e posaçëm, emrat e anëtarëve të familjes apo personave të ndryshëm nga anëtarët e familjes me të cilët dëshiron të ketë takim. Kjo listë mund të përditësohet në çdo kohë me kërkesën e të burgosurit ose mbrojtësit të tij.

5. Takimi i të burgosurit me anëtarët e familjes apo personat e ndryshëm nga anëtarët e familjes të cilët shtohen në listën e takimeve realizohet me kalimin e të paktën 10 (dhjetë) ditëve nga përditësimi i kësaj liste.

6. Takimi bëhet nga dita e hënë deri në ditën e premte, brenda harkut kohor 07:00 deri në 15:00 në dhomë të ndarë me xham, duke komunikuar me citofoni, pa mundësi kontakti. Takimi me fëmijët deri 14 (katërmbëdhjetë) vjeç mund të realizohet pa xham ndarës.

7. Në takim nuk mund të jenë më shumë se 2 (dy) persona.

8. Takimi është i mbikëqyrtur me kamera dhe me regjistrim audio.

9. Takimet e të burgosurit me anëtarët e familjes apo personat e ndryshëm nga anëtarët e familjes bëhen me rezervim paraprak, jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë përpara takimit. Rezervimi mund të bëhet nga vetë i burgosuri, anëtarët e familjes apo persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes.

10. Me paraqitjen e kërkesës verifikohet identiteti i personit, bëhet verifikimi në regjistrin e indeksit alfabetik dhe më pas bëhet regjistrimi në regjistrin e takimeve të të burgosurve duke u përcaktuar sipas një kalendari të caktuar data, ora, ambienti dhe kohëzgjatja e zhvillimit të takimit, e cila u njoftohet paraprakisht të interesuarit për takim dhe të burgosurit.

11. Në rast të mosparaqitjes në afatin e caktuar të anëtarëve të familjes apo personave të ndryshëm nga anëtarët e familjes, për sa është e mundur, institucioni merr masa për zhvillimin e takimit brenda së njëjtës ditë.

12. Vizitorët nuk lejohet të sjellin për të burgosurin sende apo ushqime të asnjë lloji a kategorie. Në rastet kur nga kontrolli konstatohet se nga vizitorët tentohet të futen sende të ndaluara që i posedojnë vetë, pezullohet takim dhe ndiqen procedurat ligjore. Për rastet e sendeve të ndaluara që përbëjnë vepër penale njoftohet Prokuroria, ndalohet personi dhe bëhet kallëzim për ndjekje penale.

13. I burgosuri, para daljes për takim dhe pas kthimit, kontrollohet në prani të 3 (tre) punonjësve të sigurisë.

14. Takimet dokumentohen në regjistrin e takimeve të regjimit të posaçëm, ku shënohen të dhëna të të burgosurit, data dhe ora e takimit, të dhënat e personave me të cilët takohet dhe lidhja që kanë.

15. Lidhja familjare e të burgosurit duhet të vërtetohet me dokumente ligjore, të cilat verifikohen paraprakisht për vërtetësinë e tyre.

Neni 66

Komunikimi me telefon

1. I burgosuri, ka të drejtë të kryejë 1 (një) telefonatë me familjen në muaj, që zgjat jo më shumë se 10 (dhjetë) minuta.

2. I burgosuri duhet të deklarojë numrat e telefonit të anëtarëve të familjes me të cilët dëshiron të komunikojë.

3. Biseda telefonike regjistrohet.

4. Me qëllim informimin e të burgosurit, mbi kartofon vihet shënimi “Kujdes! Kjo bisedë dëgjohet”.

5. Kur i burgosuri nuk ka kryer takim gjatë muajit, ai bën kërkesë te drejtori i institucionit me anë të një formulari për të kryer bisedë telefonike, ku përcakton numrin e telefonit të personit me të cilin do të komunikojë. Formulari i kërkesës miratohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

6. Drejtori i institucionit, pasi verifikon faktet, i drejtohet drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve për miratimin e telefonatës, në qoftë se personi është i dënuar.

7. Drejtori i institucionit, pasi verifikon faktet, i drejtohet prokurorit për miratimin e telefonatës, në qoftë se personi është i paraburgosur.

8. Shefi i Policisë së Burgjeve, pasi merr vendimin e drejtorit për lejimin e telefonatës nga i dënuari ose urdhrin e prokurorit për të paraburgosurin, menaxhon daljen e të burgosurit në Sektorin e Regjimit të Posaçëm për të komunikuar me telefon.

9. Kartofoni duhet të jetë i montuar në një distancë që nuk mund të arrihet nga i burgosuri.

10. Numri i kërkuar nga i burgosuri dhe i miratuar nga drejtori ose prokurori formohet nga punonjësi i sigurisë që është i ngarkuar me këtë detyrë.

11. Shërbimi i Sigurisë mban regjistër për regjistrimin e komunikimeve telefonike, ku shënohen të dhënat e të burgosurit, data dhe ora e komunikimit, numri i telefonit dhe emri i personit me të cilin komunikon.

Neni 67

Komunikimi me Avokatin e Popullit

I burgosuri mund të komunikojë në telefon me Avokatin e Popullit pa pagesë dhe në çdo kohë, bazuar në procedurat që përshkruhen në ligjin për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve. Numrat e telefonit të Avokatit të Popullit nuk përfshihen në listën e numrave të telefonit, të miratuar për çdo të burgosur.

Neni 68

Menaxhimi i sigurisë

1. Në regjimin e posaçëm të gjitha veprimet me të burgosurin kryhen në praninë e 2 (dy) ose më shumë punonjësve të policisë, sipas vlerësimit të rrezikshmërisë dhe nivelit të bashkëpunimit.

2. Në hyrje të regjimit të posaçëm mbahet regjistër, ku dokumentohet çdo veprim, si dhe gjithë aktiviteti që kryhet në sektor.
3. Të gjitha lëvizjet e të burgosurve menaxhohen dhe komunikohen me anë të telefonit ose radiove të institucionit.
4. Të burgosurit i nënshtrohen kontrollit me duar në çdo rast të hyrje-daljes në sektorin e regjimit të posaçëm apo në institucion.
5. Kontrollat me duar, sipas nevojës, plotësohet me kontrole me anë të pajisjeve teknike.
6. Të gjitha mjediset e banimit i nënshtrohen kontrollit të elementeve fizike çdo ditë. Kontrolli drejtohet nga punonjësi i nivelit të mesëm i ngarkuar me regjimin e posaçëm, duke mbajtur shënimet përkatëse.
7. Të burgosurit mbikëqyren gjatë të gjithë qëndrimit jashtë mjediseve të banimit.
8. Vendosja në mjediset e banimit dhe në mjediset e aktiviteteve bëhen pas vlerësimit të riskut.
9. Në rastin e nevojave për shoqërim jashtë institucionit, për arsye shëndetësore, hetimore, gjyqësore apo çdo arsye tjetër, vlerësohet nëse ka një alternativë tjetër për realizimin e këtyre nevojave.
10. Procedurat e transportit bazohen në udhëzuesin dhe vlerësimin e riskut të miratuar nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.
11. Gjatë lëvizjeve jashtë institucionit, të burgosurit duhet të jenë të lidhur me pranga.

Neni 69

Personeli, kompetencat, përgjegjësitë

1. Punonjësit e policisë zgjidhen për të punuar në regjimin e posaçëm bazuar në aftësitë profesionale dhe duke i informuar në mënyrë të detajuar për vështirësitë dhe specifikat e këtij shërbimi.
2. Në regjimin e posaçëm zgjidhen punonjës të cilët duhet të kenë jo më pak se 3 (tre) vite eksperiencë pune në sistemin e burgjeve.
3. Punonjësit e përzgjedhur duhet të karakterizohen nga integriteti i lartë dhe ndërgjegjësimi për shërbimin ndaj publikut, aftësi të larta komunikuese me shkrim dhe me gojë, gjendje e mirë fizike dhe qëndrueshmëri, aftësi të bashkëpunimit dhe punës në grup, aftësi për të punuar në stres dhe nën presion, aftësi dhe shprehje të mira në të gjitha veprimet, si: kontroll fizik, përdorim të mjeteve dhe pajisjeve të kontrollit, përdorim të mjeteve kufizuese dhe mjeteve të forcës, shoqërim, ndërhyrje, etj.
4. Punonjësi i Policisë së Burgjeve i planifikuar me shërbim në regjimin e posaçëm, çdo vit, i nënshtrohet trajnimeve sipas programeve përkatëse.
5. Për shkak të vështirësisë, rrezikut dhe rëndësisë, punonjësit e planifikuar në regjimin e posaçëm përfitojnë vështirësi shërbimi shtesë në krahasim me shërbimet e tjera në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.
6. Në regjimin e posaçëm planifikohen në çdo vend shërbimi jo më pak se 3 (tre) punonjës të policisë, për turn.
7. Në rast se ka situata të prishjes së rendit dhe sigurisë merren masa për përforsime të shërbimeve, duke bashkëpunuar me reparte të specializuara të Policisë së Burgjeve dhe Policisë së Shtetit, sipas marrëveshjes së përbashkët të lidhur mes tyre.
8. Në rastet e transferimeve apo shoqërimeve jashtë institucionit vihet në dijeni Policia e Shtetit për bashkëpunim.
9. Ndërrimi i shërbimit në regjimin e posaçëm kryhet në prani të marrësit, dorëzuesit dhe grupit të sigurisë të ngarkuar me detyrë në këtë regjim, si dhe specialistit të informacionit.
10. Procedurat e marrjes dhe dorëzimit të shërbimit janë të njëjta, sipas skemës së vendshërbimeve të institucionit përkatës.

11. Punonjësit që marrin shërbimin dhe çdo punonjës tjetër që hyn dhe del nga regjimi i posaçëm i nënshtrohet kontrollit të plotë trupor.

12. Punonjësit e policisë me shërbim në regjimin e posaçëm, gjatë 24 (njëzet e katër) orëve ushtrojnë këto detyra:

a) marrin shërbimin, sipas procedurave të parashikuara në skemën e sigurisë, duke numëruar të burgosurit;

b) kontrollojnë elementet e sigurisë dhe funksionimin e pajisjeve që janë në sektor;

c) informohen mbi situatën dhe problematikat e sektorit nëpërmjet kolegut që dorëzon detyrën dhe specialistit të nivelit të mesëm;

ç) marrin të gjithë çelësat, pajisjet e kontrollit dhe regjistrat;

d) hartojnë procesverbalin, të cilin e nënshkruajnë;

dh) zbatojnë orarin e veprimeve të miratuar nga drejtori i institucionit;

e) shoqërojnë kuzhinierin dhe infermierin gjatë shpërndarjes së ushqimit ose medikamenteve;

ë) hapin dyert një nga një dhe bëjnë shoqërimin e të burgosurit në ajrim;

f) shoqërojnë të burgosurin nga ajrimi në mjedisin e banimit;

g) komunikojnë me të burgosurin në rastin e përdorimit të ziles në mjedisin e banimit;

gj) bëjnë numërimin e të burgosurve gjatë ndërrimit të turneve dhe e mbajnë nën mbikëqyrje gjatë kohës së shërbimit;

h) raportojnë me shkrim në çdo rast të shkeljes së rregullave të regjimit të posaçëm;

i) vëzhgojnë vazhdimisht të burgosurit duke parë sjelljet, aktivitetet, marrëdhëniet, komunikimin, emocionet dhe raportojnë me shkrim kur ka informacion të karakterit inteligjent sipas formatit standard, pranë oficerit të informacionit.

KREU VII

VIZITAT, TAKIMET DHE MBAJTJA E KORRESPONDENCËS

Neni 70

Vizitat me anëtarët e familjes ose me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes

1. Të burgosurit kanë të drejtën e zhvillimit të vizitës të paktën 4 (katër) herë në muaj me anëtarët e familjes ose me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes, me një kohëzgjatje të paktën 1 (një) orë. Kur organizimi i institucionit e lejon, i burgosuri mund të autorizohet të qëndrojë me anëtarët e familjes ose me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes përtej kufirit kohor të parashikuar.

2. I burgosuri deklaron në momentin e pranimit emrat e anëtarëve të familjes ose me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes me të cilët dëshiron të ketë takim. Kjo listë mund të përditësohet në çdo kohë me kërkesën e të burgosurit ose mbrojtësit të tij.

3. Takimi i të burgosurit me anëtarët e familjes ose me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes, të cilët shtohen në listën e takimeve, realizohet me kalimin e të paktën 10 (dhjetë) ditëve nga përditësimi i kësaj liste.

4. Në çdo vizitë lejohen fëmijët e mitur dhe 3 (tre) persona madhorë.

5. Vizitat bëhen nga dita e hënë deri në ditën e premte, brenda harkut kohor 07:00 deri në 15:00, në ambientet e takimeve me vizitorët në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale.

6. I paraburgosuri ka të drejtën e vizitës me anëtarët e familjes ose me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes me miratimin paraprak me shkrim të prokurorit.

7. Grave të burgosura që kanë fëmijë u mundësohen vizita më të shpeshta me fëmijët e tyre, të paktën 6 (gjashtë) herë në muaj, me kohëzgjatje jo më pak se 1 (një) orë.

8. Vizitat e zgjatura lejohen për të dënuarit e martuar ose bashkëjetues, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Kodin e Familjes, pasi bashkëjetesa të jetë verifikuar nga Policia e Shtetit, 1 (një) herë në muaj dhe jo më shumë se 4 (katër) orë.

9. Në çdo institucion duhet të ketë ambiente të veçanta për vizita bashkëshortore. Këto ambiente duhet të jenë të pajisura me shtretër dhe me komplete të përshtatshme, të cilat duhet të ndërrohen sapo të mbarojë vizita bashkëshortore.

10. Të burgosurit kanë të drejtë të zëvendësojnë 1 (një) vizitë fizike me atë *online*.

11. Drejtori i institucionit, në zbatim të vendimit të prokurorit apo të gjykatës, kufizon të drejtën e të burgosurit të presë vizita nëse kjo është e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale penale.

12. Në rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësive natyrore, nevojave të sigurisë apo me kërkesë të të burgosurit, vizitat fizike mund të zëvendësohen me takimet virtuale nëpërmjet platformave të komunikimit *online* të instaluara në institucionet përkatëse të ekzekutimit të vendimeve penale. Procedurat për formatin e komunikimit *online* miratohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

Neni 71

Procedurat për vizitat me anëtarët e familjes ose me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes

1. Vizitat e të burgosurit me anëtarët e familjes ose me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes bëhen me rezervim paraprak, jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë përpara vizitës. Rezervimi mund të bëhet nga vetë i burgosuri, anëtarët e familjes ose nga persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes.

2. Me paraqitjen e kërkesës së të burgosurit, anëtarit të familjes ose personave të ndryshëm nga anëtarët e familjes verifikohet identiteti i personit, bëhet verifikimi i numrit të vizitave në regjistrin e indeksit alfabetik dhe më pas bëhet regjistrimi në regjistrin e takimeve të të burgosurve duke u përcaktuar sipas një kalendari të caktuar data, ora, ambienti dhe kohëzgjatja e zhvillimit të vizitave, e cila u njoftohet paraprakisht të interesuarit për takim dhe të burgosurit.

3. Për zhvillimin e vizitës njoftohet përgjegjësi i regjimit të brendshëm i cili lajmëron të burgosurin mbi ardhjen e anëtarëve të familjes ose personave të ndryshëm nga anëtarët e familjes dhe merr masa për organizimin e vizitës.

4. Në rast të mosparaqitjes në afatin e caktuar të anëtarëve të familjes ose personave të ndryshëm nga anëtarët e familjes, institucioni merr masa për zhvillimin e vizitës brenda së njëjtës dite, për sa e lejon kalendari ditor i zhvillimit të vizitave. Në çdo rast, institucioni nuk duhet të cenojë apo shmangë të drejtën e vizitës të të burgosurve të tjerë, duke favorizuar takimin e planifikuar.

5. Në rastet kur nga kontrolli konstatohet se nga vizitorët tentohet të futen sende të ndaluara që i posedojnë vetë, pezullohet takimi dhe ndiqen procedurat ligjore. Për rastet e sendeve të ndaluara që përbëjnë vepër penale njoftohet Prokuroria, ndalohet personi dhe bëhet kallëzim për ndjekje penale.

6. Kur vizitori tenton të fusë sende të ndaluara, drejtori i institucionit vendos moslejimin e takimeve për këtë vizitor për një periudhë nga 3 (tre) deri në 6 (gjashtë) muaj.

Neni 72

Vëzhgimi i vizitave

1. Vizitat zhvillohen në vendet e caktuara nën mbikëqyrjen vizuale të personelit mbikëqyrës.

2. Në rast se personeli mbikëqyrës i policisë konstaton se vizitorët tentojnë apo kryejnë shkëmbime sendesh të ndaluara me të burgosurin, ndërpret menjëherë takimin dhe njofton specialistin e informacionit.

3. Pas përfundimit të kohës së vizitës, personeli mbikëqyrës njofton specialistin e informacionit për shoqërimin e të burgosurit në regjimin e brendshëm, si dhe shoqërimin e daljen e vizitorëve nga institucioni.

Neni 73

Korrespondenca

1. Çdo i burgosur ka të drejtë të mbajë korrespondencë dhe t'i garantohet fshehtësia e saj.
2. Për të burgosurin që nuk ka mundësi financiare të realizojë mbajtjen e saj, personeli i institucionit, vë në dispozicion mjetet e nevojshme për korrespondencë.
3. Korrespondenca duhet të hidhet në kutinë postare të institucionit, e cila merret nga një punonjës i shërbimit postar të institucionit, i caktuar për këtë detyrë. Shpërndarja e korrespondencës së ardhur bëhet nga personeli i institucionit.
4. Në rastet kur ka dyshime të bazuara se në korrespondencë ka sende të ndaluara, ajo hapet në prani të të burgosurit dhe të drejtorit të institucionit dhe mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë të pranishmit.
5. Drejtori i institucionit, në zbatim të vendimit të prokurorit ose të gjykatës, mund të kufizojë të drejtën e të burgosurit për korrespondencë.

Neni 74

Bisedat telefonike

1. Të burgosurit i lejohen 8 (tetë) herë në muaj biseda telefonike me familjarët, të afërmit dhe në raste të veçanta me të tretët, me shpenzimet e tij. Drejtori i institucionit lejon kryerjen e bisedave telefonike shtesë dhe në këtë rast shërbimi telefonik përballohet nga vetë i burgosuri. Bisedat telefonike zhvillohen nën mbikëqyrjen vizuale të personelit.
2. Të burgosurit të mitur dhe grave u lejohen 16 (gjashtëmbëdhjetë) herë në muaj biseda telefonike.
3. Në rastet kur i burgosuri nuk ka mjete financiare për të kryer biseda telefonike me familjarët, kjo e fundit i sigurohet 4 (katër) herë në muaj deri në 5 (pesë) minuta me shpenzimet e institucionit ose me komunikimin *online*.
4. Drejtori i institucionit, me vendim të prokurorit ose gjykatës, kufizon të drejtën e të burgosurit për biseda telefonike.

Neni 75

Takimet e të burgosurve të huaj me përfaqësitë diplomatike

1. Të burgosurit me shtetësi të huaj i krijohen të gjitha lehtësitë e nevojshme për komunikimin me përfaqësuesit diplomatikë ose konsullorë të shtetit përkatës.
2. Të burgosurit, shteti i të cilit nuk ka përfaqësi në Republikën e Shqipërisë, refugjatëve, si dhe personave pa shtetësi, u krijohen të njëjtat lehtësira për të komunikuar me përfaqësuesit diplomatikë të shtetit që merr përsipër mbrojtjen e interesave të tyre ose me autoritetet kombëtare apo ndërkombëtare që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e interesave të tyre.
3. Përfaqësuesit diplomatikë dhe konsullorë kanë të drejtë të zhvillojnë takime në çdo kohë me shtetasit e tyre të burgosur, me njoftimin paraprak të institucionit.
4. Përfaqësitë diplomatike mund të kryejnë takime me të burgosur shqiptarë dhe të shtetësive të tjera, ku gjatë procedurave të ekstradimit apo të transferimit të këtyre shtetasve nga këto vende për në Shqipëri, një kërkesë e tillë është parashtruar prej tyre dhe konfirmuar nga autoritetet shqiptare.

Neni 76

Takimet me prokurorë, mbrojtës ose oficerë të Policisë Gjyqësore

1. Gjyqtarët, prokurorët, si dhe oficerët e Policisë Gjyqësore të deleguar vizitojnë, pa autorizim, institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale për të zhvilluar veprime procedurale me të burgosurin.
2. Mbrojtësit e të burgosurit lejohen të marrin takim me të burgosurin, kundrejt aktit të përfaqësimit.
3. Takimet e gjyqtarit, prokurorit, oficerit të policisë gjyqësore, lejohen në çdo kohë.
4. Të burgosurit kanë të drejtë të zhvillojnë takime në çdo kohë me përfaqësuesin e tyre ligjor.

Neni 77

Takimet me Avokatin e Popullit

1. Avokati i Popullit, komisionerët dhe ndihmëskomisionerët e tij takohen me të burgosurin, në çdo kohë, pa njoftimin paraprak të institucionit.
2. Takimi i të burgosurit me Avokatin e Popullit, komisionerët dhe ndihmëskomisionerët realizohet pa praninë e personave të tjerë dhe nuk mbikëqyret.
3. Kontrolli dhe hyrja e Avokatit të Popullit, komisionerëve dhe ndihmëskomisionerëve në regjimin e brendshëm të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale kryhet me procedura të thjeshtëzuara.

Neni 78

Takimet me noterët dhe punonjësit e gjendjes civile

1. Të burgosurit lejohen të takohen me noterin e zgjedhur për kryerjen e veprimeve ligjore.
2. Të burgosurit shoqërohen në zyrën e gjendjes civile për lidhje martesë apo për aplikimin për kartë identiteti ose pasaportë ose çdo veprim të ligjshëm në kompetencë të kësaj zyre.

Neni 79

Hyrja në institucion

1. Personat e tjerë, të ndryshëm nga ata të cilët parashikohen në ligj se mund të hyjnë në institucion pa autorizim, mund të hyjnë në institucion vetëm me autorizim të drejtorit të institucionit, pas kërkesës së depozituar prej tyre.
2. Miratimi apo refuzimi i autorizimit për të hyrë në institucion duhet të jetë i motivuar.
3. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, bazuar në kërkesën e motivuar, autorizon hyrjen e mediave në mjediset e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale. Në rastin e të paraburgosurve, merret miratimi paraprak me shkrim i prokurorit.
4. Ndalohet realizimi i filmimeve në mjediset e banimit të të burgosurve, si dhe transmetimi i emisioneve të drejtpërdrejta nga mjediset e institucionit.
5. Në kërkesën për pajisje me autorizim duhet të shpjegohen hollësisht arsyet për të cilat kërkohet hyrja në institucion. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentin e identifikimit të kërkuesit dhe dokumentet që vërtetojnë arsyen e kërkesës, nëse ka. Kur kërkuesi është një person juridik, kërkesa duhet të shoqërohet me autorizimin për t'u përfaqësuar nga personi fizik i caktuar në kërkesë.

Neni 80

Kontrolli personal i vizitorëve

1. Personat që kanë të drejtë të realizojnë takim apo vizitë me të burgosurit i nënshtrohen kontrollit nga ana e Policisë së Burgjeve fizikisht apo me pajisje teknologjike. Personeli që bën kontrollin duhet të jetë i së njëjtës gjini me atë të personit që kontrollohet.

2. Kontrollat e vizitorëve të të burgosurve bëhen duke respektuar personalitetin dhe dinjitetin e tyre dhe pa dëmtuar sendet që ata posedojnë.

3. Pasi verifikohet identiteti i personit që do të takojë të burgosurin dhe autorizimi për të hyrë në institucion, vijohet me kontrollin e tij duke i shpjeguar paraprakisht në çdo rast me gjuhë të kuptueshme arsyet e kontrollit personal, si dhe ndalimin e futjes së sendeve në institucion.

4. Kontrolli i vizitorëve bëhet në ambiente të veçanta, në të cilën lejohet të futet vetëm vizitori dhe punonjësit e Policisë së Burgjeve. Kur vizitor është edhe 1 (një) person i mitur kontrolli bëhet në praninë e prindit apo kujdestarit të tij.

5. Në rastin e një dyshimi të arsyeshëm për posedim të sendeve të ndaluara kryhet kontroll i imtësishëm, i cili kryhet në çdo rast, në praninë e jo më pak se 2 (dy) punonjësve.

KREU VIII

RUAJTJA DHE SIGURIMI I TË BURGOSURVE TË PUNËSUAR JASHTË INSTITUCIONIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

Neni 81

Shoqërimi i të burgosurve të punësuar jashtë institucionit

1. Shoqërimi i të burgosurve të punësuar jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale kryhet nga grupet e sigurisë dhe shoqërimit të Policisë së Burgjeve.

2. Gjatë shoqërimit tregohet kujdesi i duhur për ta ekspozuar sa më pak të burgosurin në publik.

3. Shoqërimi i grave të burgosura kryhet nga personeli i së njëjtës gjini.

4. Në të gjitha rastet, shoqërimi i të burgosurit të punësuar jashtë institucionit bëhet me dokumentacionin përkatës.

5. Gjatë shoqërimit, në të gjitha rastet e përdorimit të mjeteve kufizuese, personeli është i detyruar të garantojë mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të personave.

KREU IX

NORMAT E SJELLJES SË TË BURGOSURVE DHE DISIPLINA

Neni 82

Trajtimi, regjimi dhe sjellja e të burgosurve në institucion

1. Trajtimi i të burgosurve bëhet duke siguruar mjediset dhe mjetet e përshtatshme, në përputhje me personalitetin, arsimin, gjendjen social-ekonomike, prirjet dhe aftësitë që ata kanë, duke synuar rehabilitimin për riintegrimin e tyre në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike, dhe uljen e recidivizmit.

2. Institucioni i ekzekutimit të vendimit penal zhvillon programe të cilat synojnë rehabilitimin dhe riintegrimin e këtyre personave në shoqëri.

Neni 83

Detyrimet e të burgosurit

1. I burgosuri ka detyrim të zbatojë rregullat e institucionit, si dhe të ketë sjellje korrekte me të burgosurit e tjerë dhe personelin e institucionit.

2. I burgosuri, gjatë qëndrimit në institucion, detyrohet:

- a) të mbajë të pastër e të rregullt mjedisin e banimit dhe mjediset e përbashkëta;
- b) të kujdeset për higjienën personale;
- c) të mos mbajë dhe qarkullojë sende të ndaluara, të cilat rrezikojnë rendin, jetën dhe shëndetin e të burgosurve dhe personelit, objekte që përbëjnë vepër penale, mjete që ndikojnë negativisht në hetim, si dhe vlera monetare të çdo lloji;
- ç) të krijojë marrëdhënie korrekte me të burgosurit e tjerë, si dhe me personelin e institucionit;
- d) të zbatojë udhëzimet e personelit të institucionit;
- dh) të dëmshpërblejë vlerën përkatëse në rastet e dëmtimit të materialeve që janë pronë e institucionit ose e të burgosurve të tjerë;
- e) të zbatojë programet ditore të institucionit;
- ë) të respektojë dinjitetin e pjesëtarëve të komunitetit dhe të personelit;
- f) të informojë menjëherë drejtorin e institucionit për rrethanat që mund të rrezikojnë sigurinë, jetën e të burgosurve ose shkeljen e rregullave të brendshme në institucion.

Neni 84

Përgjegjësia për shkaktimin e dëmit

1. Në rastin e dëmtimit të një sendi të luajtshëm ose të paluajtshëm, pronë e institucionit, drejtoria e institucionit duhet të përcaktojë dëmtuesin dhe masën e dëmit, dhe pasi dëgjon të burgosurin e njofton atë për vlerën e dëmit sipas vlerës së kontabilizuar në inventarin e institucionit, duke e ftuar që ta shlyejë atë vullnetarisht.

2. Nëse i burgosuri apo familjarët kanë kontestime në lidhje shkaktimin e dëmit ose masën e dëmshpërblimit atëherë ata i drejtohen brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve me ankesë drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe në rast mospranimi të kërkesës, i drejtohen brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve gjykatës kompetente, sipas afateve dhe procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për funksionimin e gjykatave administrative.

3. Në rast dëmtimi të sendeve të të burgosurve nga njëri-tjetri, drejtoria e institucionit ndërmjetëson për zgjidhjen me mirëkuptim të çështjes.

4. Dëmshpërblimi vullnetar gjatë shqyrtimit të masës disiplinore përbën rrethanë lehtësuese. Në rast të kundërt, ndiqet procedura e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

5. Të njëjtat rregulla zbatohen edhe kur punonjësit e institucionit dëmtojnë sendet e të burgosurit.

Neni 85

Veprat penale në institucion

Për hetimet mbi një vepër penale të dyshuar se është kryer nga të burgosurit brenda institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, zbatohen rregullat e Kodit të Procedurës Penale njëjloj si për hetimin e veprave penale të kryera jashtë institucionit.

Neni 86

Regjimi disiplinor lehtësues

Ndaj të burgosurit të mitur, të burgosurit të diagnostikuar me çrregullime të shëndetit mendor, të burgosurit që ka pasur përvoja të dhunës fizike, psikologjike ose të abuzimit seksual, zbatohet regjimi disiplinor lehtësues.

Procedurat për zbatimin e regjimit disiplinor lehtësues

1. I burgosuri i diagnostikuar me çrregullime të shëndetit mendor, në rastet e kryerjes së shkeljeve disiplinore, i nënshtrohet masave disiplinore të parashikuara në ligjin për trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosur, për aq sa kuptohet rëndësia e tyre nga i burgosuri dhe për aq sa i shërbejnë qëllimit të tyre rehabilitues.

2. Ndaj të burgosurit të diagnostikuar me çrregullime të shëndetit mendor, masa disiplinore e përjashtimit nga veprimtaritë e përbashkëta nuk mund të jepet nëse ndikon në përkeqësimin e gjendjes së tij, bazuar në raportin mjekësor.

3. Nëse është në interes të të burgosurit dhe në funksion të qëllimit rehabilitues, kohëzgjatja e masave disiplinore të parashikuara në ligj përgjysmohet.

4. I burgosuri që ka pasur përvoja të dhunës fizike, psikologjike ose abuzim seksual që kryen shkelje të rregullave disiplinore, i nënshtrohet fillimisht masës disiplinore të këshillimit individual dhe paralajmërohet për masat që mund të merren ndaj tij në vijim. Nëse i burgosuri përsërit shkelje disiplinore brenda një periudhe 3 (tre)-muajore, zbatohen masat disiplinore të parashikuara në ligj, për aq kohë sa i shërbejnë qëllimit të tyre rehabilitues.

5. Për dhënien e masave ndaj kësaj kategorie merret mendimi me shkrim i punonjësit të shërbimit social në institucion.

6. Masat disiplinore të përjashtimit nga veprimtaritë e përbashkëta, nuk mund të jepen pa pasur një raport paraprak të lëshuar nga mjeku, që vërteton gjendjen fizike dhe mendore të të burgosurit.

Shkeljet disiplinore

1. Ndaj të miturit që kryen shkelje disiplinore në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale vendosen masa disiplinore në përputhje me përcaktimet e bëra në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

2. Shkeljet disiplinore klasifikohen në:

- a) shkelje të lehta;
- b) shkelje të rënda;
- c) shkelje shumë të rënda.

3. Shkelje të lehta disiplinore janë:

a) neglizhenca në kryerjen e pastrimit personal, të mjedisit të banimit apo të mjediseve të përbashkëta;

b) simulimi i sëmundjes.

4. Shkelje të rënda disiplinore janë:

a) përdorimi i fjalëve të pahijshme, fyese dhe denigruese ndaj personelit të institucionit ose të burgosurve të tjerë;

b) kryerja e veprimeve me qëllime përfitimi;

c) moszbatimi i urdhrave të personelit të institucionit ose vonesa e pajustificuar në zbatimin e tyre.

5. Shkelje shumë të rënda disiplinore janë:

a) organizimi, pjesëmarrja dhe nxitja e veprimtarive, që cenojnë masat e sigurisë në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale;

b) kundërshtimi me dhunë i punonjësve të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale;

c) ushtrimi i dhunës fizike ose psikike ndaj të burgosurve të tjerë;

ç) përgatitja dhe përpjekja për t'u larguar nga institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale ose gjatë shoqërimit të të burgosurit;

- d) përvetësimi ose dëmtimi me dashje i pasurisë së institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale ose të burgosurve të tjerë;
- dh) dhuna verbale ose sjellja agresive ndaj të burgosurve të tjerë;
- e) mbajtja, përdorimi dhe qarkullimi i sendeve të ndaluara, kur nuk përbën vepër penale;
- ë) përdorimi i lëndëve narkotike ose psikotrope dhe pijeve alkoolike;
- f) shkelja e afatit të kthimit në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale pas lejes, pa arsye objektive të vërtetuara.

Neni 89

Organi kompetent dhe procedurat për dhënien e masave disiplinore

1. Masat disiplinore ndaj të miturit të burgosur jepen nga komisioni për dhënien e masave disiplinore. Komisioni disiplinor përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë:

- a) Drejtori i institucionit, në cilësinë e kryetarit;
- b) Përgjegjësi i sektorit ligjor;
- c) Përgjegjësi i sektorit të sigurisë;
- ç) Përgjegjësi i sektorit të kujdesit social;
- d) Specialisti i sektorit të kujdesit social që trajton të dënuarin.

2. Komisioni disiplinor ngrihet dhe funksionon me urdhër të drejtorit të institucionit, i cili mbledh komisionin disiplinor jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë nga momenti i konstatimit të shkeljes.

3. Përpara fillimit të shqyrtimit disiplinor, mjeku përgatit një raport mjekësor ku shprehet për gjendjen shëndetësore të të burgosurit të mitur ndaj të cilit ka filluar procedura disiplinore. Raporti vihet në dispozicion të komisionit disiplinor dhe shqyrtohet prej tij për efekt të përcaktimit të masës disiplinore. Mjeku merr pjesë në mbledhjet e komisionit disiplinor pa të drejtë vote dhe ka të drejtë të japë sqarime nëse kjo kërkohet nga komisioni disiplinor.

4. Shkelja disiplinore e të miturit të burgosur shqyrtohet në një seancë dëgjimore, me përjashtim të rastit kur i mituri prish rregullin ose pengon kryerjen e seancës, nuk merr pjesë ose refuzon të marrë pjesë në të. Ky fakt pasqyrohet në procesverbalin e mbajtur gjatë kësaj seancë.

5. Gjatë seancës dëgjimore i mituri i burgosur ka të drejtë të jetë i ulur, të marrë shënime e të japë shpjegime me gojë.

6. I mituri i burgosur ka të drejtë për të pasur një mbrojtës në seancën dëgjimore të shqyrtimit të shkeljes disiplinore. Përpara se të fillojë seanca dëgjimore, i mituri informohet për të drejtën për të pasur një mbrojtës, gjë që ushtrohet brenda 6 (gjashtë) orëve nga dhënia e informacionit, në rast se ka një pëlqim të lidhur me të. Në rast se mbrojtësi nuk paraqitet në kohën e përcaktuar, të miturit i caktohet një mbrojtës kryesisht. I mituri jep pëlqimin lidhur me mbrojtësin kryesisht. Shpenzimet për mbrojtjen kryesisht mbulohen sipas parashikimeve të legjislacionit për ndihmën juridike.

7. Përpara fillimit të shqyrtimit disiplinor, mjeku përgatit një raport mjekësor ku shprehet për gjendjen shëndetësore të të miturit të burgosur ndaj të cilit ka filluar procedura disiplinore. Raporti vihet në dispozicion të drejtorit të institucionit dhe shqyrtohet prej tij për efekt të përcaktimit të masës disiplinore.

8. Procedimi disiplinor ndaj të miturit të burgosur zhvillohet në prani të të miturit dhe avokatit të tij mbrojtës. Nëse i mituri e kërkon, procedimi disiplinor zhvillohet edhe në prani të prindit apo të kujdestarit të tij ligjor.

9. I burgosuri i mitur ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor ka të drejtë:

- a) të informohet menjëherë në mënyrë të qartë dhe në një gjuhë që është e kuptueshme prej tij për faktet, shkeljet dhe masat disiplinore që mund të vendosen;
- b) të dëgjohet dhe t'i jepen koha dhe lehtësitë e mjaftueshme për të parashtruar pretendime dhe prova në mbrojtje të tij;

- c) të kërkojë thirrjen dhe dëgjimin e dëshmitarëve;
 - ç) të përfitojë falas ndihmën e një përkthyesi kur nuk kupton ose flet gjuhën shqipe.
10. Vendimi i arsyetuar i drejtorit të institucionit për dhënien e masës disiplinore merret brenda 10 (dhjetë) ditëve nga konstatimi i shkeljes dhe i njoftohet të burgosurit të mitur.

Neni 90

Ankimi ndaj masave disiplinore

1. Masat disiplinore ndaj të burgosurit, organi kompetent dhe procedura e dhënies së tyre realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve.
2. I burgosuri ka të drejtë ta ankimojë masën disiplinore pranë komisionit të apelit të masave disiplinore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga njoftimi me shkrim i vendimit për dhënien e masës disiplinore.
3. I burgosuri ka të drejtë të përfaqësohet nga mbrojtësi i tij ligjor në çdo fazë të ankimit.
4. Të njëjtat rregulla për ankimin e masave disiplinore zbatohen dhe nga i burgosuri i mitur.

Neni 91

Komisioni i apelit të masave disiplinore

1. Komisioni i apelit të masave disiplinore (në vijim Komisioni) krijohet dhe funksionon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.
2. Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë. Një prej anëtarëve të Komisionit kryen rolin e Kryetarit të Komisionit.
3. Në ushtrimin e veprimtarisë së tij Komisioni asistohet nga një sekretar në përputhje me legjislacionin në fuqi për organet kolegjiale.
4. Përbërja e Komisionit caktohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.
5. Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se 3 anëtarë.
6. Nëse në mbledhjen e Komisionit janë të pranishëm 4 (katër) anëtarë dhe votat ndahen në mënyrë të barabartë, do të konsiderohet se ankimi është pranuar.

Neni 92

Procedura e shqyrtimit të ankimit nga Komisioni i Apelit të Masave Disiplinore

1. Ankimi ndaj masës disiplinore, së bashku me kopjen e akteve shkresore me të cilat ankuesi provon pretendimet e tij, regjistrohen nga sekretari i Komisionit dhe i kalohen menjëherë kryetarit, i cili brenda 3 (tre) ditëve njofton anëtarët e Komisionit për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes.
2. Pas shqyrtimit të kriterëve formale ligjore, si: kompetenca, legjitimitimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji, lidhur me ankimin dhe dokumentacionin, Komisioni shqyrton elementet që lidhen me masën disiplinore dhënë ndaj të burgosurit dhe bazueshmërinë e saj.
3. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave, që kanë lidhje me masën disiplinore të dhënë, Komisioni mund:
 - a) të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertë;
 - b) të marrë dokumente dhe të dhëna, dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;
 - c) të vizitojë dhe të kontrollojë mallrat apo vende të përfshira.
4. I burgosuri ose përfaqësuesi i tij ka të drejtë të paraqesë me shkrim mendime dhe shpjegime për faktet, rrethana apo çështje ligjore, si dhe të depozitojnë prova ose të paraqesë propozime për zgjidhjen e çështjes.

Neni 93
Konflikti i interesit

1. Anëtari i Komisionit jep dorëheqjen nga shqyrtimi i ankimit të masës disiplinore kur ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas përcaktimeve të bëra në Kodin e Procedurave Administrative. Ky detyrim vlen dhe për anëtarët e Komisionit Disiplinor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

2. Në rast se anëtari i komisionit paraqet shkaqe të konfliktit të interesit me të burgosurin, i cili ka ushtruar ankim, mbledhja ndërpritet dhe Komisioni vlerëson shkaqet duke përjashtuar ose jo nga vendimmarrja anëtarin e Komisionit, si dhe njofton palët për seancën e radhës. Mbledhja e radhës nuk mund të caktohet më vonë se 5 (pesë) ditë pune.

3. I burgosuri mund t'i kërkojë Komisionit përjashtimin e pjesëmarrjes së një anëtari të Komisionit nga procedura administrative deri në marrjen e vendimit, duke parashtruar arsyet për të cilat kërkohet përjashtimi nga vendimmarrja.

4. Nëse një prej anëtarëve të Komisionit ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, Komisioni i paraqet kërkesë drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve për emërimin e anëtarit zëvendësues për çështjen në shqyrtim.

Neni 94
Vendimmarrja e Komisionit

1. Komisioni i apelimit vendos lënien në fuqi, shfuqizimin ose kthimin për rishqyrtim të vendimit të komisionit disiplinor brenda 14 (katërmbëdhjetë) ditëve nga marrja e ankimit.

2. Komisioni vendos me shumicë votash nën drejtimin e Kryetarit, i cili voton në fund.

3. Vendimi i Komisionit që përfundon procedurën e shqyrtimit të ankimit, nënshkruhet nga Kryetari dhe të gjithë anëtarët e tij.

4. Masa disiplinore fillon efektin e saj nga momenti i marrjes së një vendimi nga komisioni disiplinor. Masa disiplinore “përjashtim nga veprimtaritë e përbashkëta” zbatohet pas kalimit të afatit ligjor brenda të cilit i burgosuri ka të drejtë të ankimojë vendimin ose pas lënies në fuqi nga Komisioni i Apelit.

5. Në çdo rast Komisioni i Apelit njofton me shkrim të burgosurin për vendimin e tij duke i njohur me të drejtën e ankimit, mjetet e ankimit, afatin dhe mënyrën e përlllogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit në gjykatë sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

KREU X
RREGULLA MBI SIGURINË

Neni 95
Ndalimet

1. Ndalohet mbajtja e armëve të zjarrit brenda ambienteve të banimit të të burgosurve.

2. Mbajtja e shkopinjve të gomës apo mjeteve të kufizimit fizik mund të lejohet vetëm në rastet kur ato nevojiten për sigurinë e institucionit.

3. Armët e zjarrit përdoren sipas kushteve dhe kritereve të legjislacionit në fuqi për përdorimin e armëve të zjarrit.

Neni 96
Përdorimi i forcës dhe mjeteve të kufizimit fizik

1. Përdorimi i forcës fizike ndaj të burgosurit nuk lejohet, me përjashtim të rasteve kur është i nevojshëm për vetëmbrojtje, për të ndaluar aktet e dhunshme, sulmin fizik ndaj një të burgosuri tjetër, tentativat e largimit nga institucioni, vetëdëmtimin ose në rast të rezistencës aktive ose pasive ndaj një urdhri të ligjshëm. Forca përdoret si mjet i fundit dhe nuk duhet të ketë karakter ndëshkues.

2. Masa e forcës së përdorur duhet të jetë në minimumin e mundshëm dhe përdoret në kohën më të shkurtër të mundshme. Në çdo rast përdorimi i mjeteve të shtrëngimit fizik kryhet në mënyrë të përshkallëzuar, në proporcion me situatën dhe nivelin e rrezikut, dhe duhet të jetë i kufizuar në kohë. Përdorimi i mjeteve të shtrëngimit fizik, për një periudhë më të gjatë se 48 orë, bëhet me miratimin e prokurorit.

3. Në çdo rast, ndalohet përdorimi i forcës për qëllime të torturës, trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose degradues. Përdorimi i mjeteve të shtrëngimit nuk duhet të tejkalojë kufizimet e vendosura në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve harton dhe realizon një plan trajnimi të personelit të institucioneve për teknika që mundësojnë përdorimin minimal të forcës për të ndaluar sjelljet agresive.

5. Ndalohet përdorimi i prangave apo këmishëve të forcës, me përjashtim të rasteve kur forma të tjera të përdorimit të forcës më pak intensive kanë dështuar. Prangat mund të përdoren nëse janë të domosdoshme për të parandaluar një sjellje të dhunshme ose kur i burgosuri bën përpjekje për t'u arratisur. Prangat hiqen kur i burgosuri shfaqet para një organi gjyqësor apo administrativ, me përjashtim të rastit kur ky autoritet vendos ndryshe. I burgosuri vendoset në mes të 2 (dy punonjësve) të sigurisë.

6. Ndalohet përdorimi i mjeteve të kufizimit fizik më gjatë se sa është e nevojshme. Ndalohet përdorimi i zinxhirëve dhe hekurave.

7. Izolimi në një dhomë të veçuar, si mjet kufizimi i përkohshëm, përdoret vetëm përjashtimisht dhe vetëm për pak orë dhe në çdo rast nuk duhet të kalojë 24 (njëzet e katër) orë.

8. Në rast të dëmtimit fizik, të burgosurit i jepet menjëherë ndihma mjekësore, e cila pasqyrohet në kartelën shëndetësore.

9. Në rastet e vetëdëmtimit të të burgosurit, institucioni përdor mjete të veçanta të kufizimit fizik. Për vendosjen apo kohëzgjatjen e kufizimit fizik merret në çdo rast mendimi i mjekut të institucionit. Mjeku i institucionit vlerëson rregullisht nëse përdorimi i mjeteve kufizuese duhet të vazhdojë ose jo. Staf i mjekësor bën vlerësimin e riskut të të burgosurit, përcakton kohëzgjatjen e kufizimit dhe dokumenton rastin në kartelën klinike dhe në regjistrin e kufizimit fizik. Përgjegjësi i sektorit të sigurisë, cakton një punonjës përgjegjës për kujdesin dhe mbikëqyrjen e të burgosurit. I burgosuri duhet të marrë ushqim dhe pije në intervale të rregullta kohore.

10. Në rastin e tejkalimit të masës së përdorimit të forcës nga ana e personelit të institucionit, ndaj tyre veprohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 97

Rregulla mbi sigurinë gjatë shoqërimit

1. Shoqërimi i të burgosurve bëhet ditën, në raste të veçanta, kur ka urgjenca, mund të bëhet edhe natën, por me masa të përforcuara sigurie.

2. Shoqërimi i të burgosurve bëhet, në stinën e dimrit nga ora 07:00 deri në orën 16:00 dhe në stinën e verës nga ora 05:00 deri në orën 19:00, me përjashtim të rasteve të veçanta.

3. Të burgosurit gjatë shoqërimit mbahen të ulur në sedilje dhe të prangosur me duar përpara.

Neni 98

Kontrolli i personelit të institucionit

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ushtron kontroll ndaj personelit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale në çdo rast të futjes në institucion dhe në rastet kur ekziston dyshimi i arsyeshëm që personeli fsheh në trup sende të ndaluara.

2. Kontrolli personal kryhet nga punonjës të së njëjtës gjini me personin e kontrolluar, në praninë e jo më pak se dy punonjësve dhe në mënyrë që shmang mundësinë e shikimit nga punonjësi i gjinisë tjetër.

3. Në të gjitha rastet e kontroleve, kur ekziston dyshimi i arsyeshëm që personeli fsheh në trup sende të ndaluara, punonjësi i Policisë së Burgjeve harton një raport ku jepen arsyet e kryerjes së kontrollit dhe rezultatet e tij.

Neni 99

Situatat emergjente

Kufizimi në grup i të drejtave, në situata emergjente, bëhet me urdhër të ministrit të Drejtësisë, sipas kriterëve të legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve, si dhe kësaj rregulloreje.

Neni 100

Masat në rastet e situatave emergjente

1. Llojet e masave në rastet e situatave emergjente janë:

a) rritja e masave të nivelit të sigurisë në institucion, në përputhje me vlerësimin e rrezikut dhe nivelin e klasifikimit të gatishmërisë, sipas urdhrit të ministrit të Drejtësisë;

b) transferimi i përkohshëm i të burgosurit në një institucion më të përshtatshëm të kryerjes së dënimit;

c) kufizimi dhe pezullimi i aktiviteteve në institucion deri në përfundimin e situatës emergjente.

KREU XI

PËRFITIMI I LEJES SË VEÇANTË, TRANSFERIMI I TË BURGOSURIT DHE TRANSPORTIMI PAS LIRIMIT

Neni 101

Lejet e veçanta

1. I burgosuri ka të drejtë të përfitojë leje të veçantë në rast të sëmundjeve të rënda, të cilat rrezikojnë jetën e anëtarëve të familjes, të vërtetuar me raport mjekësor, ose të ngjarjeve të rëndësishme familjare, si vdekje, lindje ose martesë, si dhe në rastet e dhënies së provimeve të vetë të dënuarit. Kjo periudhë përfshihet në kohën e vuajtjes së dënimit.

2. Leja e veçantë për të dënuarin jepet nga drejtori i institucionit, ndërsa për të paraburgosurin jepet nga drejtori i institucionit, me pëlqimin paraprak të prokurorit.

3. Leja e veçantë jepet për një kohëzgjatje deri në 48 orë. Leja e veçantë mund të zgjatet me kërkesë të të burgosurit edhe 24 orë të tjera vetëm për rastet e sëmundjeve të rënda, të cilat vërtetohen me dokumentacionin përkatës. Zgjatja e lejes miratohet në përputhje me pikën 2, të këtij neni.

4. Kundër vendimit të drejtorit të institucionit për refuzimin e lejes së veçantë mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijeni e vendimit të refuzimit.

Leja e veçantë në rast të sëmundjeve të rënda

1. Në kuptim të kësaj rregulloreje, me sëmundje të rëndë do të kuptohet çdo sëmundje apo patologji, që vë në rrezik në mënyrë serioze shëndetin apo jetën e anëtarit të familjes së të burgosurit (bashkëshorti/bashkëshortja, prindërit, fëmijët, gjyshërit, vëllezërit dhe motrat, si dhe bashkëjetuesi/bashkëjetuesja, bashkëjetesa e të cilëve ka një karakter të qëndrueshëm dhe të provuar), në atë masë që mund të sjell si pasojë vdekjen e tij dhe që, për këtë shkak, kërkon kujdes të veçantë mjekësor.

2. I burgosuri paraqet pranë drejtorit të institucionit dokumentacionin, si më poshtë:

- a) kërkesën për leje të veçantë;
- b) dokumentacionin nga gjendja civile, që provon lidhjen familjare të të burgosurit me të sëmurin, i cili duhet të jetë lëshuar nga organet kompetente, jo më parë se 10 (dhjetë) ditë;
- c) dokumentacionin mjekësor që provon sëmundjen e rëndë që rrezikon jetën;
- ç) kopje të dokumentit të identifikimit të anëtarit të familjes të sëmurë.

3. Dokumentacioni mjekësor që shoqëron kërkesën për leje të veçantë vlerësohet edhe nga përgjegjësi i sektorit të shëndetësisë në institucion ose, në mungesë të tij, nga mjeku i institucionit, i cili vlerëson epikrizën mjekësore, duke kontrolluar të gjitha elementet që provojnë vërtetësinë e saj. Pas kësaj, ai shprehet me shkrim për shkallën e rrezikshmërisë së sëmundjes së anëtarit të familjes së të burgosurit, duke verifikuar dhe epikrizën përmes komunikimit me telefon me mjekët që kanë nënshkruar.

4. Mendimi me shkrim i përgjegjësit të sektorit të shëndetësisë ose mjekut të institucionit, me propozimin për dhënie ose jo të lejes së veçantë, mbahet në konsideratë përpara përgatitjes së raportit të përbashkët nga ana e sektorit ligjor, sigurisë dhe kujdesit social.

Leja e veçantë në rast të lindjeve, martesave apo vdekjeve të anëtarëve të familjes

1. Leja e veçantë jepet për shkak të lindjes, martesës apo vdekjes së anëtarëve të familjes së të burgosurit

2. Për lejen e veçantë që jepet në rastet e lindjes së anëtarit të familjes, i burgosuri paraqet pranë drejtorit të institucionit dokumentacionin, si më poshtë:

- a) kërkesën për leje të veçantë;
- b) dokumentacionin nga gjendja civile, që provon lidhjen familjare të të burgosurit me anëtarin e familjes, të lëshuar jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë nga dorëzimi i kërkesës për leje të veçantë;
- c) certifikatën e lindjes së anëtarit të familjes së të burgosurit, të lëshuar jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë nga dorëzimi i kërkesës për leje të veçantë apo vërtetimin nga çdo institucion shëndetësor, i cili sipas legjislacionit në fuqi për gjendjen civile, ka të drejtë të njoftojë lindjen.

3. Për lejen e veçantë që jepet në rastet e martesës së anëtarit të familjes ose vetë të burgosurit, i burgosuri paraqet pranë drejtorit të institucionit dokumentacionin si më poshtë:

- a) kërkesën për leje të veçantë;
- b) dokumentacionin nga gjendja civile, që provon lidhjen familjare të të burgosurit me anëtarin e familjes, të lëshuar jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë nga dorëzimi i kërkesës për leje të veçantë, kur martohet një anëtar i familjes;
- c) certifikatën e martesës ose kërkesën për shpallje martese të lëshuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore, ku secili nga bashkëshortët e ardhshëm ka vendbanimin ose vendqëndrimin;
- ç) vërtetimin për datën e zhvillimit të ceremonisë së martesës.

4. Për lejen e veçantë, që jepet në rastet e vdekjes së anëtarit të familjes, i burgosuri paraqet pranë drejtorit të institucionit dokumentacionin, si më poshtë:

- a) kërkesën për leje të veçantë;
- b) dokumentacionin nga gjendja civile, që provon lidhjen familjare të të burgosurit me anëtarin e familjes që ka vdekur, të lëshuar jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë nga dorëzimi i kërkesës për leje të veçantë;
- c) skedën origjinale të vdekjes së anëtarit të familjes, të lëshuar nga autoriteti përgjegjës shtetëror apo vërtetimin nga mjeku i zonës përkatëse ku ka ndodhur vdekja, sipas legjislacionit në fuqi për gjendjen civile.

Neni 104

Leja e veçantë në rast të dhënies së provimeve nga i dënuari

1. I dënuari përfiton leje të veçantë në rastet e dhënies së provimeve pranë institucioneve arsimore.

2. I burgosuri paraqet pranë drejtorit të institucionit dokumentacionin, si më poshtë:
- a) kërkesën për leje të veçantë;
 - b) vërtetim për ndjekjen e studimeve pranë institucionit arsimor;
 - c) dokumentacionin nga institucioni arsimor mbi datën, vendin dhe orën e zhvillimit të provimeve.

Neni 105

Procedura për dhënien e lejeve të veçanta

1. Drejtori i institucionit me marrjen e kërkesës nga i burgosuri për leje të veçantë, brenda 24 (njëzet e katër) orësh nxjerr një urdhër me shkrim për fillimin e procedurave për dhënien e lejes së veçantë nga sektorët përgjegjës.

2. Drejtori i institucionit pasi shqyrton kërkesën dhe raportin e përbashkët të sektorit ligjor, kujdesit social dhe të sigurisë, brenda ditës i kthen përgjigje të arsyetuar me shkrim të burgosurit lidhur me miratimin ose refuzimin e kërkesës.

3. Në rastin e miratimit të lejes së veçantë për personat e burgosur, drejtori i institucionit nxjerr urdhër me shkrim duke përcaktuar mënyrën, kushtet, mjetet e shoqërimit të të burgosurit me forcat e Policisë së Burgjeve dhe numrin e tyre.

4. Leja e veçantë përmban dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kërkesën e të burgosurit;
- b) urdhrin e drejtorit të institucionit për fillimin e procedurave të shqyrtimit të kërkesës;
- c) kthim përgjigjen drejtuar të burgosurit;
- ç) raportin e përbashkët të sektorëve;
- d) urdhrin për miratimin e lejes së veçantë.

5. Vendimi për dhënien e lejes së veçantë u njoftohet menjëherë strukturave të Policisë së Shtetit, të juridiksionit të vendit ku do të qëndrojë i burgosuri.

6. Kërkesa për leje të veçantë, raporti, vlerësimi, urdhri për fillimin e procedurave për dhënien e lejes, kthim përgjigje të burgosurit, urdhri i miratimit të lejes, njoftimi i strukturave të Policisë së Shtetit bëhen sipas formateve të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi për përcaktimin e procedurave të dhënies së lejeve shpërblyese apo të veçanta për të burgosurit.

Neni 106

Kërkesa e të burgosurit për transferim

1. Kërkesa për transferim mund të paraqitet nga i burgosuri ose familjarët e tij, për arsye shëndetësore, familjare, shkaqe që kanë të bëjnë me formimin profesional, arsimimin, si dhe çdo element tjetër të përfshirë në planin e trajtimit individual, kur i rrezikohet jeta ose shëndeti, si dhe për shkak të afërsisë me vendbanimin e familjarëve të tij.

2. Kërkesa për transferimin e të burgosurit mund të paraqitet nga prokurori i çështjes për nevoja të hetimit dhe gjykimit.

3. Kërkesa për transferimin e të burgosurit mund të paraqitet nga drejtori i institucionit në rastet e mbipopullimit në institucion, për arsye sigurie kur rrezikohet jeta ose shëndeti i të burgosurit nga të tjerë, forca madhore, si dhe për të gjitha rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

4. Të burgosurit transferohen së bashku me sendet vetjake, dosjen personale dhe dosjen psikosociale.

5. Transferimi i të burgosurit nuk mund të kryhet nëse nuk është i shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

Neni 107

Shqyrtimi i kërkesës për transferim

1. Me paraqitjen e kërkesës për transferimin e të burgosurit, drejtori i institucionit e regjistron menjëherë kërkesën në një regjistër të veçantë dhe urdhëron përkatësisht sektorin ligjor, sektorin e ruajtjes dhe sigurisë, sektorin e kujdesit shëndetësor apo sektorin e kujdesit social që brenda një afati 5 (pesë) ditor nga dita e regjistrimit të kërkesës, të përgatisë një raport të hollësishëm sipas argumentimit të paraqitur në kërkesë.

2. Kur kërkesa për transferim bazohet në arsye të rënda sigurie, kur rrezikohet jeta ose shëndeti i të burgosurit nga të tjerët ose kur ka mbipopullim në institucion, sektori i sigurisë përgatit një raport të arsyetuar dhe të hollësishëm ku jepen të dhëna dhe prova për vërtetimin e shkakut për transferimin e të burgosurit.

3. Kur kërkesa për transferim bazohet në nevojat e hetimit dhe gjykimit, sektori ligjor përgatit një raport të arsyetuar dhe të hollësishëm ku jepen të dhëna mbi gjendjen gjyqësore të të burgosurit, dinamikën e vuajtjes së dënimit, si dhe për referencat zyrtare të ardhura nga organet e drejtësisë ku është kërkuar transferimi i të burgosurit.

4. Kur kërkesa për transferim bazohet në shkaqe shëndetësore, sektori i kujdesit shëndetësor përgatit një raport të arsyetuar dhe të hollësishëm ku jepen të dhënat e nevojshme mbi gjendjen shëndetësore të të burgosurit, raportet dhe analizat mjekësore që vërtetojnë gjendjen e të burgosurit, si dhe nevojën shëndetësore për transferimin e tij.

5. Kur kërkesa për transferim bazohet në shkaqe familjare, të formimit profesional, arsimimin, si dhe çdo element tjetër të përfshirë në planin e trajtimit individual, si dhe në afërsinë me vendbanimin e familjarëve të tij, sektori i kujdesit social përgatit një raport të arsyetuar dhe të hollësishëm ku jepen të dhëna për gjendjen familjare, vendbanimin e familjarëve të të burgosurit, gjendjen sociale, arsimore dhe profesionale të tij, si dhe për referencat zyrtare të ardhura nga institucionet e tjera shtetërore, të cilat vërtetojnë shkakun familjar, të vendbanimit të familjarëve, si dhe formimin profesional.

6. Për kërkesat për transferim, sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni, bëhet vlerësimi i riskut nga sektori i policisë, sipas masave të sigurisë.

7. Institucioni ku ndodhet i burgosuri mund të kërkojë nga institucionet e tjera shtetërore të dhëna provuese apo shtesë lidhur me shkakun e transferimit të të burgosurit, të cilat i bashkëlidhen raportit.

8. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, duke filluar nga momenti i regjistrimit të kërkesës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, kryen veprimet, si më poshtë vijon:

a) vlerëson mundësinë e transferimit të të burgosurit bazuar në kriteret ligjore;

b) analizon rrezikshmërinë bazuar në vlerësimin e riskut të të burgosurit;

c) përcakton institucionin ku do të transferohet i burgosuri.

9. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve nxjerr urdhrin për transferimin e të burgosurit. Në rast të refuzimit të kërkesës, i burgosuri njoftohet me shkrim. I burgosuri ka të drejtë ta ankimojë urdhrin e drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve te ministri i Drejtësisë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga vënia e tij në dijeni për refuzimin e kërkesës.

10. Në rast të refuzimit të kërkesës nga ministri i Drejtësisë, i burgosuri ka të drejtë ta ankimojë urdhrin brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga vënia e tij në dijeni për refuzimin e kërkesës, në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 108

Transferimi i të burgosurit

1. Transferimi i të burgosurit kryhet duke zbatuar masat e sigurisë dhe duke respektuar dinjitetin e tij.

2. Transferimi i të burgosurit bëhet ditën, në raste të veçanta, kur ka urgjenca, mund të bëhet edhe natën, por me masa të përforcuara sigurie.

3. Transferimi i të burgosurit bëhet, në stinën e dimrit nga ora 07:00 deri në orën 16:00 dhe në stinën e verës nga ora 05:00 deri në orën 19:00, me përjashtim të rasteve të veçanta.

4. Transferimi i të burgosurit kryhet me mjete transporti që krijojnë kushte të përshtatshme për transferim. Të burgosurit mbahen të ulur në sedilje, të prangosur me duar përpara.

5. I burgosuri, përpara se të transferohet, i nënshtrohet kontrollit personal dhe vizitohet nga mjeku, i cili verifikon gjendjen psiko-fizike të tij dhe konkludon nëse është në gjendje të përballojë udhëtimin. Nëse i burgosuri nuk mund të përballojë udhëtimin, drejtori i institucionit njofton drejtorin e Përgjithshëm, i cili vlerëson kryerjen e transferimit në një kohë tjetër.

6. Në çdo rast të kryerjes së transferimeve të të burgosurit, personeli i policisë harton dhe administron procesverbalet e marrjes në dorëzim dhe të dorëzimit të të burgosurit dhe të sendeve të tij personale.

Neni 109

Shërbimi i kujdesit shëndetësor jashtë institucionit

1. Nëse i burgosuri ka nevojë për trajtim shëndetësor, i cili nuk ofrohet nga shërbimet e kujdesit shëndetësor të institucionit ose kërkohet prej tij, merren masat për transferimin në shërbimet e kujdesit shëndetësor jashtë institucionit. Gjatë transportimit, i burgosuri shoqërohet nga mjeku ose ndihmësmjeku dhe punonjësi i sigurisë.

2. Numri i punonjësve të sigurisë që bëjnë shoqërimin e të burgosurit të sëmurë në shërbimet e kujdesit shëndetësor jashtë institucionit caktohet në varësi të situatës, rrezikshmërisë, ambienteve, por në asnjë rast jo më pak se 3 (tre) punonjës sigurie për një të burgosur.

3. Vizitat caktohen në fshehtësi të plotë, duke bërë marrëveshje të posaçme me drejtuesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor jashtë institucionit.

4. Vizitat jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale dhe mbikëqyrja spitalore kryhen bazuar në procedurën e sigurisë gjatë shoqërimeve, duke ruajtur konfidencialitetin e plotë të lëvizjeve dhe shmangur çdo lloj komunikimi dhe kontakti.

5. I burgosuri i sëmurë që shtrohet në spital mbikëqyret nga punonjësit e sigurisë i pa prangosur.

6. Në rastet kur i burgosuri është vlerësuar me nivel të lartë rrezikshmërie për t'u arratisur, kur shoqërohet jashtë dhomës ku është i shtruar, mund të përdoren mjete kufizuese për të parandaluar ndonjë arratisje të mundshme.

Neni 110

Transportimi i të burgosurve pas lirit

1. I liruari, shtetas shqiptar, që nuk ka mjete të mjaftueshme financiare, me urdhër të drejtorit të institucionit i sigurohet ndihma e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve të transportit deri në vendbanimin e tij, në masën dhe sipas kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore.

2. Pas verifikimeve nga njësi përgjegjëse për financat, nëse i burgosuri nuk ka mjete monetare për të siguruar transportin në vendbanimin e tij, institucioni i siguron të burgosurit biletën e udhëtimit deri në vendbanimin e tij, sipas dokumenteve që vërtetojnë vendbanimin e tij të përhershëm ose të zakonshëm.

3. Kur i burgosuri ka probleme shëndetësore që nuk mundësojnë largimin e tij, drejtori i institucionit urdhëron transportimin e tij me një mjet të përshtatshëm deri në vendbanimin e tij.

Neni 111

Dhënia e informacionit medias dhe publikut

1. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale i vendosin në dispozicion medias dhe publikut informacionin e kërkuar, me përjashtim të informacionit apo të dhënave që cenojnë të drejtën për jetë private, të dhënat sensitive apo çdo informacion tjetër, nëse dhënia e këtij informacioni cenon sigurinë e institucionit apo proceseve hetimore e gjyqësore, në zbatim të legjislacionit për të drejtën e informimit.

2. Njësi përgjegjëse në institucion për dhënien e informacionit palëve të treta, përpunon të dhënat e të burgosurve dhe të institucionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Në rastin kur informacioni kërkohet nga një person i tretë, zbatohet legjislacioni në fuqi për të drejtën e informimit.

KREU XII

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 112

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve që, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, të miratojë rregulloret e brendshme të çdo institucioni të ekzekutimit të vendimeve penale.

2. Ngarkohet ministri i Drejtësisë, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe drejtuesit e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të nenit 14, pika 4, nenit 19, pika 2, nenit 29, pika 6, nenit 35, pika 4, nenit 52, pika 2, nenit 66, pika 5 dhe nenit 70, pika 12, të kësaj rregulloreje.

3. Rregulloret e brendshme të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale mbeten në fuqi deri në miratimin e rregulloreve të reja, për aq sa nuk bien ndesh me parashikimet e kësaj rregulloreje.

